

ALFRED KANINI

Mbi një platformë betoni



tregime



891. P85-32

S

K 2 P

ALFRED KANINI

MBI NJË PLATFORMË BETONI

~~54557~~



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

NË NJË NATË TË FTOHTË

Nëpër degët e larta të pishave, të mbuluara me një cipë dëborë po rrokullisej dalëngadalë një mbrëmje e ftohtë. Ajo madje u var e ra edhe në kasollen e vogël të ngritur midis drurëve të lartë, që tani kishte mbetur e braktisur. Në të kishin bujtur për një muaj rresht dymbëdhjetë njerëz të pyjeve dhe traktoristi. Ata sapo e kishin lënë sheshin e vogël e ishin futur në pyll. Vendin në sheshin e vogël filloi ta zinte oshëtima e pyjeve, që nisi të rendëte dru më dru e t'ja merrte këngës tej grykave të thella. Netët sa vinin e po ftoheshin.

Të dymbëdhjetë punëtorët e pyjeve kishin bërë goxha rrugë nëpër monopatin që kishte filluar të ngrinte. Sado që kishin një muaj që nuk ishin shkulur që andej, ata herë-herë kthenin kokën si të donin të përshëndeteshin me kasollen e braktisur. Po kasollja tani kishte humbur diku mes drurëve, e vetëm kur të vinte pranvera do ta shihnin përsëri.

— Ç'ke Adil? — se kush e pyeti në mugëtirë një punëtor që kishte qëndruar me kokën kthyer pas.

— Se si më vjen, — tha Adili — sikur po largohem nga shtëpia.

Ai që pyeti qeshi. Adili kishte punuar shumë atë muaj. Dhe dukej sikur kishte zënë miqësi me kasollen.

— Epo kishim për ta lanë një ditë, — tha Marku. — Si thue ti, Hamit?

— Unë jam shumë i lodhur, — tha Hamiti — dhe, të them të drejtën, nuk ndjej ndonjë gjë të veçantë për kasollen. Vetëm se më vjen mirë që na mbrojti një muaj nga të ftohtët.

— Ti ke punuar shumë, Hamit, — tha Marku — prandaj s'ndjen gjë.

— Dhe Adili ka punuar shumë, — se kush tha — bile ka luftuar me trupat.

Adili vazhdoi rrugën në heshtje. Dhe kur hesht, fillojnë të lëvizin mendimet, ngjarjet...

«Kemi punuar shumë — tha me vete, — dhe tani çdo gjë përfundoi me sukses. S'dua veç të vrapoj në fshat e të takoj...»

Pastaj mendimet nisën një të rendur të shpejtë, më shpejt se ç'po rendnin ata, për atje larg, në fshat. Aty rrihte një zemër për të. Një muaj të tërë nuk e kishte parë. Kishte folur vetëm me sytë e saj, që e ndiqnin dhe aty, dhe që e ngrohnin në netët e ftohta. Dhe s'e ndjente lodhjen...

Të dymbëdhjetëve nga pas u vinte traktori dhe traktoristi hipur mbi të.

«Më në fund e fituam edhe këtë betejë të lodhshme» mendonte Adili. Edhe të tjerët kishin rënë në mendime.

— Hamit, ti po hesht shumë sonte — tha Marku.

Hamiti sikur u përmend:

— Eh, lëre! — tha — mezi pres të fle në shtresa të buta, të kem dhe një zjarr bubulak. — Ai vuri

buzën në gaz. — Sigurisht edhe vogëlushët të më fërkojnë shpatullat. . .

Të dymbëdhjetë mendonin gjithsecili më vete. Edhe traktoristi ashtu mendonte, sado që ja zbehte mendimet ajo trakarima e fortë e traktorit. Të gjithë atë çast i lidhte një mendim: shtresat e buta dhe zjarri bubulak në vatër. Se më në fund do të pushonin. E ç'u duhej tjetër pas një muaj pune të lodhshme?

Arritën në skelën e brigadës, aty mbi xhadenë që pret mespërmes pyjet. Dhe shtangën të dymbëdhjetë!

— Maqina! — tha nervoz Adili.

Nga kthesa vinin vazhdimisht maqina.

— Me siguri ndonjë autokollonë ushtarake, — foli Marku.

Po ato filluan të qëndronin te skela e tyre.

«Ç'do të thotë kjo»? — mendoi Hamiti.

— Duan të ngarkohen. Unë or vëlla s'kam më fuqi, — tha Adili.

Edhe të tjerët thanë se s'kishin më fuqi, po Hamiti heshti.

Shoferët filluan t'u afroreshin njerëzve të pyllit, atyre që rrëzojnë drurë e përgatitin trupa trunjesh për industrinë dhe që i ngarkojnë pastaj nëpër maqina. Në pyje kishte filluar të frynte erë e fortë.

— Mirësejgjejmë, burra? — ja nisi shoferi i maqinës së parë.

— Mirëseerdhët, — ja kthyen nëpër dhëmbë punëtorët. Shoferi ja nisi bisedës me Hamitin.

— Paskeni ardhë vonë, — foli Hamiti.

— Ç'të bënim, — shoferi ngriti supet, — rruget kanë shumë dëborë.

Marku u tha se dëborë do të binte gjithë natën

dhe u dha shoferëve të kuptonin se nuk kishin bërë mirë që kishin ardhur.

— Me aksionin tuaj ju e plotësuar planin e gjashtëmujorit brenda një muaji, — tha shoferi, — mirëpo nevojiten edhe dhjetë maqina. — Pastaj shtoi se ata të dhjetë kishin vendosur të çanin dëborën për t'u kthyer në ndërmarrje me ato dhjetra m³ trupa që duheshin.

— Dhjetë maqina?! — Adili nxori një fishkëllimë të gjatë. — Të ishin dy, hajde de.

Të tjerët heshtën. Hamiti vuri re një farë mërzitje te shokët dhe ju drejtua shoferëve.

— Nuk prisni dot gjer nesër? — i pyeti. — Ne të gjithë jemi shumë të lodhur.

Shoferët thanë se nuk mund të prisnin dot gjer të nesërmen. Rrugët me siguri do të ziheshin nga dëbora, dhe atyre do t'u duhej të qëndronin gjithë natën me motor të ndezur që të mos u çaheshin nga të ftohtët. Punëtorët i dëgjonin në heshtje.

— Unë për vete jam shumë i lodhur, — tha pastaj Adili.

Dhe të tjerët thanë se ishin shumë të lodhur. Po Hamiti heshti. Ndërsa traktoristi, që qe afruar dhe e kishte dëgjuar përse flitej, tha:

— Ne punuam një muaj pa pyetur për lodhje. Ç'do të na kushtojë dhe një natë?

Hamiti u hodhi nga një vështrim shokëve. Ata kishin fytyra të lodhura. Dhe në errësirë punohej me vështirësi, se toka ishte e ngrirë, dhe trungjet nuk presin radhën, po shkasin.

— Sidoqoftë, unë nuk mundem, — tha Adili.

— Ne mund të punojmë edhe me fenerë, — murmuriti Marku.

Shoferët, që kishin dalë të gjithë nga kabinat e

ngrohta, i vështronin si me të lutur. Edhe ata kishin lënë shtresat e buta dhe dhomën e nxehtë për t'ja siguruar trupat ndërmarrjes.

— Unë nuk mundem, — tha prapë Adili. Dhe mendoi: «Tani e paskan gjetur këta?» Pastaj vështroi Hamitin. Atij i duhej të vendoste, se ai ishte brigadieri. Po në fund të fundit, as brigadieri s'mund ta detyronte të bënte një punë të tepërt. Në sytë e brigadierit ai vuri re atë që s'i shkonte ndërmend. Me sa dukej ai kishte vendosur të punonin. Edhe të tjerët dukej se kishin lënë mënjanë lodhjen dhe prisnin ç'do të thoshte Hamiti.

— Ne duhet të ngarkojmë maqinat, — tha pastaj Hamiti duke ju drejtuar Adilit. — Duhet ta shohim me një sy tjetër këtë punë.

— Po jam i lodhur!

— Edhe ne jemi të lodhur, — tha Marku, — edhe ne duam zjarr, duam shtresa të buta. Se mos kemi punuar më pak?

— Ju mund të thoni ç'të doni, po unë nuk rri se u teket këtyre të nisen natën, — tha i rrëmbyer Adili. Dhe mendja i vajti te vajza me sy të kaltër, që me siguri e priste. Mirëpo këtë s'mund t'ua tregonte shokëve.

Shoferët e vështruan gjatë dhe të prekur në se-dër.

— Ne vendosëm të vinim vetë këtu, — tha një shofer, — sado që na u desh të kalonim një rrugë të vështirë. Trupat i duhen patjetër ndërmarrjes.

— Mua aq më bën, — tha prerë Adili. Ai i kishte premtuar asaj se atë natë do të kthehej. Mbase do ta gjente në shtëpinë e kulturës. Do ta takonte dhe do t'i tregonte për punën e atij muaji. Sa shumë kishte për t'i thënë!

— Unë do të iki, — tha më në fund ai.

U kryqëzuan vështrime. Adili i ndjeu të binin të gjitha mbi të si një tufë shkopinjshe të gjatë e të mprehtë. Pastaj ndjeu sytë e mëdhenj të Hamitit. Se ç'i thoshin ata! Hamiti e kish dashur gjithmonë. Adili nuk ja kishte përtuar ndonjëherë punës, asaj punës së tyre të vështirë e të lodhshme.

— Do të punojmë dhe pa ty, — tha pastaj Hamiti. Të tjerët mbetën të habitur. Pastaj deshën të ndërhyjnë. Deshën dhe t'i mbushnin mendjen me të mirë brigadierit se punën e Adilit s'e bënte njeri aty.

— Nuk ka kush ta bëjë punën e tij, o Hamit, — tha traktoristi, që përfytyroi në çast skenën kur Adili shtynte trupat në lug.

— Le të shkojë, — tha Hamiti.

Adili nuk e zgjati, po rrëshqiti monopateve për në fshat.

— Punën e Adilit është e vështirë ta bëjë një tjetër, — tha Marku.

— Do të bëjmë si të bëjmë. — Hamiti e ndau brigadën në dy grupe: katër veta dhe traktoristi do të ngjiteshin lart për të rrokullisur trupat, ndërsa gjashtë të tjerë, me Markun do t'i prisnin dhe do t'i ngarkonin nëpër maqina. Dhe nata e ftohtë në të cilën qëmtonte dëborë nuk ra dot në qetësi. Zërrave të pyjeve që sjell mbrëmja, ju shtuan dhe thirrjet burrërore të njerëzve të fortë. Dhe uturima moforësh.

* * *

Adili, duke zbritur, ndjeu se ishte vërtet i lodhur. Kishte filluar të frynte erë e fortë.

«Atje duhet të fryjë ajo era e pyjeve», — men-

doi, «e ftohtë e egër, që të than veshët e të merr frymën».

Fshatarët ishin në vatrën e kulturës. Me sa dukej pas ndonjë mbledhjeje kishte çfaqje. Adili u mundua të hynte pa u vënë re. U ul diku afër derës. Mirëpo njerëzit filluan të kthenin kokën nga ai.

— Qenkan kthyer — pëshpërisnin.

— Adili, për nder!

Ai filloi të skuqej. E kuptoi që fshatarët pandehnin se ishin kthyer të gjithë. Mendoj si do ta rrethonin kur të mbaronte çfaqja dhe do ta pyesnin për shokët. Si do t'u përgjigjej? Po asaj vajzës me sy të kaltër, që me siguri e shikonte nga salla? Ç'ti thosh-te asaj?

Adili ndjeu përsëri sytë zhbironjës të fshatarëve. Sikur e pyesnin:

«Ku janë të tjerët?»

Sikur i thoshin:

«Paska ardhë vetëm Adili.»

Ai nuk mundi t'i duronte vështrimet e tyre kurreshtare e të mprehta. Dhe u mundua të dilte pa u vënë re.

«Të iki më mirë para se të mbarojë çfaqja», — tha me vete, — «ndryshe të gjithë do të më pyesin për ata».

Jashtë e mbështolli era e fortë dhe dëborë që po binte me flokë të mëdha.

— Adil! — dëgjoi prapa krahëve.

Ajo ja kishte mbërthyer sytë. Zemra nisi t'i rrihte me forcë.

— Je kthyer? — foli prapë ajo. — Sa mirë që erdhe, Adil! — Ai kishte mbetur në vend pa hapur gojë. E vështronte dhe heshte. Ashtu si trungjet e prera netëve të ftohta. Ju duk sikur ajo donte të fliste akoma. Po ai nuk po e dëgjonte dot.

Një muaj më parë ai dhe njëmbëdhjetë shokët e tij kishin ndërtuar një kasolle në këmbë të pishave të larta. Donin t'i jepnin ndërmarrjes së tyre sa më shumë trungje. Se ata e dinin që po të fillonte dëbora, trupat do të mbeteshin në pyje, sepse maqinat nuk do të arrinin dot gjer në skelat e brigadës. Ata do të prisnin gjersa të vinte pranvera e të liroheshin rrugët nga dëbora. Hamiti kishte pyetur shokët. Ata e kishin peshuar mirë punën. Atëhere Adili kishte thënë:

— Të shpallim një muaj sulmi!

— Mirë thotë, — qe hedhur traktoristi, — të qëndrojmë një muaj në pyll pa u kthyer fare nëpër shtëpitë tona.

Hamiti nuk pati nevojë t'i sqaronte se do ta kishin të vështirë. Vetëm tha se ata mund të ndërtonin një kasolle që t'i nxinte të trembëdhjetë.

— Fundja unë mund të fle dhe në traktor, — kishte thënë traktoristi nga që mendonte se do t'i shtrëngonte.

Fshati kishte dëgjuar se ata do të qëndronin një muaj në pyje pa u kthyer fare në shtëpi. Një gjë e tillë nuk u kishte ndodhur ndonjëherë, prandaj dhe nuk po kuptonin.

— Or, ç'bajnë këta?

— Kush e di!

— Ata kanë shpallë një aksion, — kishte sqaruar vajza me sy të kaltër, — do të punojnë një muaj rresht ditë e natë. — Pastaj kishte shtuar se edhe në hekurudhë punonin nganjëherë ashtu.

— Pse kështu?

— Që të mos i lënë të presin asnjë minut maqinat.

— Aha.

Kështu ata të dymbëdhjetë e kishin ndërtuar kasollen në këmbë të pishave të larta... Netët kishin filluar të ftoheshin dhe yjet të ndritnin më fort në qiellin e kthjellët. Ata të dymbëdhjetë dhe traktoristi ditën prisnin maqinat e shtynin trungjet, ndërsa kur ngrysej fillonin e ngarkonin maqinat. Vonë flinin dhe atëhere Adili rrinte shtrirë dhe mendohej:

«Sa më ngrohin sytë e saj kur jam larg».

Edhe në mëngjezet e kthjellta kur shikonte qiellin, atij i dukej sikur shikonte sytë e saj të kaltër.

Një mëngjez gjithshka ishte zgjuar e ftohtë, me një mbulesë të bardhë përsipër. Dëbora ishte futur madje edhe brënda kasolles, që ishte vende-vende e hapur.

— Bora e parë, — kishte thënë ai. — Asht e bukur kjo borë e parë!

— Thonë se i ngjan dashurisë së parë, — kishte thënë i menduar Marku. — Si thua Adil, pse t'i ngjajë dashurisë së parë?

Adilit mendja i vajti në fshat. Ju duk sikur kishte diçka të përbashkët kjo dëbora e parë me dashurinë e tij.

Dhe një çast e përfytyroi atë: të pastër, të dashur, të bukur.

— Si thua Adil?

— Ku ta dish, — qe përmendur ai. — Ndoshta ngaqë është njësoj e bukur, njësoj e pastër...

Pastaj atyre u ishte afruar Hamiti.

— Do të zihen rrugët, — kishte thënë ai i menduar, — s'di a do të mundim ta mbyllim pla-

nin. Maqinat do ta kenë vështirë për të ardhur gjer këtu.

Adili kishte menduar se brigadieri prej kohësh e kishte harruar dashurinë e parë.

Dhe netët kishin ardhur më të ftohta. Maqinat uturinin gjer në mesnatë. Të dymbëdhjetë dhe traktoristi zbrisnin monopateve. Ndaheshin. Adili përballë trupave njëtonësh, që i rrokullisnin tatë-pjetë, ndërsa Marku që poshtë nga skela e brigadës thërriste se maqinat ishin ngarkuar të gjitha. Ato net, Adilit i dukej sikur ishte në një luftë të vështirë, për të cilën ishte i sigurtë se do ta fitonte. Errësira e bardhë nuk e pengonte atë t'i priste në kohë trupat e rëndë dhe me capinin e mprehtë t'i shtynte të nënshtruar në lug. Shpesh, nga thellësia e pyllit, kishte dëgjuar Hamitin të thërriste:

— Të lumtë, Adil!

Pastaj, natën vonë maqinat e ngarkuara linin, kthesën, dhe ata ngjiteshin e flinin në kasolle, poshtë pishave. Kështu kishte kaluar një muaj rresht gjersa i kishin dhënë fund sulmit të tyre burrëror...

Po ja që kishin ardhur dhe dhjetë maqina...

* * *

Aq kishte humbur Adili në këto kujtime, sa që e kishte harruar fare atë, dhe kur ajo i foli, ai u përmend i habitur sikur të mos ndodhej aty në fshat përballë vajzës për të cilën kishte bërë gjithë atë rrugë duke lënë shokët vetëm, po sikur të qe në zemër të pyjeve duke pritur trupat që i shtynin shokët nga lart.

— Adil, ç'ke kështu? — e shkundi përsëri ajo.

Ai u habit që përballë kishte atë. Të dymbëdhjetë shokët kishin mbetur larg, në pyje të thella mbi skelën e brigadës duke luftuar me natën e ftohtë dhe me trupat e lodhjen që u rëndonte shpatullat. Dhe Hamiti kishte ndenjtur atje. E ai kishte fëmijë që e prisnin.

Adili hodhi vështrimin e vet të zymtë në sytë e vajzës që tani nata ua fshihte ngjyrën po jo shikimin e tyre të vemendshëm e të qetë. Ajo kishte një muaj që e priste. E priste me ndrojtje dhe me dashurinë e vet të thjeshtë e të pastër. Ai e dinte këtë, prandaj edhe kishte rendur nëpër errësirë. E dinte që ajo e donte ta kishte pranë, të bisedonte me të për çdo gjë. Prandaj dhe s'kishte duruar. Po ato çaste mendja po i shkonte më tepër te shokët që po luftonin në pyll.

Shikimi i saj i vemendshëm e i qetë sikur donte të thoshte diçka tjetër. Diçka që edhe u përkiste dhe s'u përkiste atyre të dyve. Atëhere ai mendoi ta pyeste për ato që kishin ndodhur në fshat gjatë kohës që ai ishte larg, t'i fliste për ëndërrat e veta netëve të ftohta, për sytë e saj të kaltër që i shihte mëngjezeve me diell.

Kur vuri re që ajo deshi të fliste përsëri, kishte harruar se ajo kishte folur disa herë pa marrë përgjegje prej tij. Megjithatë ndenji ta dëgjonte. Po ajo bëri pyetjen e vet të tretë.

— Po shokët Adil shkuan drejt e në shtëpi?

Ajo e pyeti e sigurt se të dymbëdhjetë njerëzit e pyjeve ishin kthyer bashkë me Adilin, dhe nga që do të ishin të lodhur nuk kishin ardhur aty.

Adili uli kokën duke ndjerë të skuqej. Shokët nuk ishin kthyer. Ata nuk ishin aty. Të dymbë-

dhjetë kishin qëndruar në pyll për të ngarkuar dhjetë maqinat. Se kishin ardhur dhe dhjetë maqina nëpër natën e ftohtë dhe rrugën e ngrirë. Ndërsa ai kishte ardhur vetëm. Se ishte i lodhur dhe se e priste ajo. Adili e kuptoi se duhej t'i përgjigjej menjëherë.

— Ata janë ende atje, — tha me zë të ngjirur, — kanë ardhur dhe dhjetë maqina. Dhe Hamiti atje është. — Pastaj shtoi me mend se vetëm ai s'qe atje, megjithëse ata i qenë lutur të qëndronte.

Ajo rrinte e habitur, duke u dridhur nga të ftohtët me atë vështrimin e saj të thellë e të qetë të mbërthyer në fytyrën e tij.

— Unë erdha vetëm të të shoh — ju dha të vazhdojë Adilit. — Vetëm për pak erdha. Tani do të iki se më presin shokët. Unë e di që më presin.

* * *

Adili rendte monopateve të ngrira, i mbytur në djersë. Aty në pyll ishin shokët. Lodhjen nuk e ndjente më. Gati vraponte. Vështrimi i saj i thellë e ndiqte pas, e ndiqte dhe fytyra e saj e krehur në errësirë ku ndehej një buzëqeshje që mezi shquhej.

«Ne punuam edhe natën gjatë atij muaji», mendoi ai — «Hamiti nuk pyeste për lodhje. As unë s'pyesja për lodhje. Hamiti ngrihej i pari dhe na shkundte gjumin e rëndë». «Edhe unë punova. Mirpo sonte u ndava nga ata. Pse u ndava? Ta hajë dreqi!»

Hamiti ishte rrëzues. Vetëm Adili mund t'i drejtonte trupat në lug. Hamiti nuk dinte. E kishte të vështirë të ndeshej ballë për ballë me ta. Sidomos natën në një tokë të ngrirë.

«Me siguri Hamiti po merret tani me këtë punë» — mendoi.

Uturimat e motorëve të maqinave filluan të dëgjoheshin gjer aty ku ngjitej ai.

«Po nisen maqinat e para» tha dhe rendi më shpejt. Ai doli në rrugë. Pak më tutje te një kthesë, dukeshin drita. Mbi xhade maqinat merrnin kthesën. Po niseshin dy të parat për të mos humbur kohën. Ai filloi të ngjitej nëpër lug. Aty rrëshqisnin trupa, po ai nuk u trembej. Nuk ndjente më lodhje dhe u shmangej atyre i sigurtë, duke hedhur çapin e gjatë për të arritur aty ku punonte Hamiti. Prapa e ndiqte vështrimi i saj i thellë. Përpara e priste buzëqeshja e shokëve.

~~54357~~

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIROKASTER

1389

MBI NJË PLATFORMË BETONI

Në sipërfaqen e errët të detit rrëshqisnin lehtë-lehtë dritëzat e anijeve të peshkimit. Montatorët ishin ulur nëpër ca hekura dhe vështronin anijet që linin ngadalë portin e humbisnin në det të hapur. Nga një anije u ngrit lehtë-lehtë melodia e një kënge:

*Përmbi valët shket anija
Peshkatarit përshëndet...*

— Ja ka marrë si duket ndonjë peshkatar i ri, — u dëgjua zëri i Nasit, që ishte ulur në një grumbull të madh hekurash. Të tjerët dëgjonin në heshtje me vështrimin andej nga vinte kënga. Një nga montatorët tha me zë ëndërronjës se jeta e peshkatarit ishte shumë e bukur, dhe se ai dikur kishte dashur të bëhej peshkatar.

— Është me të vërtetë e bukur, — e mbylli ai, ndërsa kënga e peshkatarit po dëgjohej gjithmonë e më e dobët.

*Në rrugën tonë s'na trëmb stuhia
vajza ime rri e qetë...*

Zëri i ëmbël i bëri montatorët të harroheshin për një çast dhe ta hiqnin mendjen nga puna që do të bënin atë ditë. Edhe Nasi kishte dashur të bëhej peshkatar. Jeta e njerëzve të detit kishte diçka që i shkonte karakterit të tij. Po kishte ndërruar mendje, kur mbi platformën e porsabetonuar, disa njerëz gazmorë kishin filluar të ngrinin vinça viganë. Atëhere ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe tani, pas dymbëdhjetë vjetëve, ai ishte bërë brigadieri i montatorëve. Ca ditë më parë, si kishin dorëzuar një elektrovinç, u kishin thënë të montonin një tjetër. Nevoja e këtij elektrovinçi ishte aq e madhe, sa që kërkonin ta montonin në një kohë rekord. Megjithatë Nasi kishte biseduar me shokët:

— Na duhet ta montojmë në dy muaj e gjysmë. Mbi platformë kishte ardhur edhe sekretari i partisë, edhe brigadieri i vinçierëve. Montatorët i dëgjuan në heshtje. Secili mendonte me një farë shqetësimi nëse mund të arrihej një gjë e tillë.

— Gjë që s'bëhet, kishte kundërshtuar një montator i shkurtër në fytyrën e gjerë të të cilit binte në sy një hundë e madhe.

— Rri, Loni, — ishin hedhur të tjerët, — ta provojmë njëherë.

— Nuk është fjala për provë.

— Sidoqoftë, ne duhet t'i përvishemi punës — e kishte mbyllur Petriti. — Veç do të bënit mirë të na dërgonit sa më parë një vinç. Brigadieri i vinçierëve u premtoi se, megjithë nevojën e madhe që kishin ata, do të mendohej t'u dërgonte ato ditë një vinç. . .

Kënga e peshkatarit sa vinte e largohej ashtu e thellë e mezi arrinte gjer në murin e gurtë të platformës. Jehona e saj u shua pastaj tej mugë-tirës, në rrafshirën e pafund të detit.

— Mbase ka rënë në dashuri, — se kush tha nga montatorët. Kjo u desh që midis tyre të ndizej një bisedë tjetër.

— Është vështirë t'i kuptosh peshkatarët kur dashurojnë, — tha Petriti, — ndoshta ngaqë qëndrojnë gjithë kohën në det dhe janë mësuar t'i përmbajnë ndjenjat. Si thua, Nasi?

— Ku ta dish, — tha Nasi. — Ndoshta flasin me detin edhe për dashuri. — Montatorët më të rinj ndenjën të dëgjonin, ndërsa, Loni, që e kishte edhe gjuhën pak të gjatë u kthye nga Nasi:

— Po ti, Nasi, a ke rënë ndonjëherë në dashuri? — e pyeti.

— Po ti?

— Ohu, sa herë të duash!

— Ç'muhabet! — ja bëri Petriti.

— Nasi vetëm vinçat dashuron, — tha një montator me shaka.

Nasit i vajti mendja te një vinçiere që punonte në depot e portit. Sa herë që i binte rruga andej, ajo dilte në dritaren e vogël të kabinës së vinçit dhe i thërriste:

— E, brigadier, ç'thonë elektrovinçat?

— Po i montojmë.

— A do të më japësh dhe mua një nga ata? — i lutej ajo.

— E ku punon dot ti me elektrovinç.

— Ke për të parë.

— Eh, mirë! — Ai largohej duke tundur shpatullat e gjera. Ajo gjithënjë dilte në dritaren e vinçit. Dhe ai gjithnjë ngrinte sytë padashur. Një ditë ajo e kishte kthyer krahun e vinçit mbi det dhe grasatonte ashtu midis kaltërsive.

— Ej, do të biesh! — i thirri Nasi, që po ka-

lonte andej. Vajza mundohej të grasatonte në lartësi pjesët e krahut të vinçit dhe ishte në rrezik të binte.

— Mos ki merak, brigadier!

Megjithatë Nasi ishte i shqetësuar dhe ajo e vuri re.

— Po rashë, në det do të bie, — i tha. Nasi mezi e dëgjoj. Bëri një gjest me dorë dhe u mat të ikte. Mirëpo ajo lëshoi ca fjalë që e mbajtën në vend.

— Ne mundohemi për fajin tuaj. — Nasi u habit dhe deshi ta pyeste si ishte puna, po ndërroi mendje. Megjithatë nuk u largua.

— Sikur të shpiknit ndonjë gjë për të grasatuar?! — shpjegoi ajo.

— Si?

— Ja ndonjë mekanizëm grasatimi, — foli prapë ajo.

Ai mendoi se vinçierja po bënte shaka dhe i tha se puna e tyre ishte vetëm të montonin. Ajo bëri një gjest me duar dhe pastaj i tha se do të takoheshin për ta biseduar shtruar këtë punë.

Dhe një ditë më parë ata ishin takuar. Ajo mbante në duar një copë letër ku ishte vizatuar diçka. Dukej e ndrojtur. Kur i fliste që atje lart, ajo nuk dukej e ndrojtur. Nasi nuk mund ta kuptonte përse ndruhej ajo. Megjithatë, duke ju dridhur duart, ajo i tha:

— Është mekanizmi. —

— Ç'mekanizëm? — e pyeti ai i habitur.

— Për të grasatuar në lartësi, — tha ajo.

— Aha!

— Si aha?

— Gjë që s'bëhet, — tha Nasi duke sjellë

ndër mend përpjekjet që ishin bërë për të mekanizuar grasatimin në lartësi të elektrovinçave. Ajo kishte menduar ditë e net për mekanizmin, kishte shfletuar sa e sa modele elektrovinçash dhe u habit që brigadieri e priti aq ftohtë.

— Pandeha se do të gëzoheshe, — tha ajo.

— Nasi u zu ngushtë nga këto fjalë. Mbase mund të gëzohej me çdo gjë që mund të bënte ajo, po ama me mekanizmin? Ai nuk donte ta fyente, po ishte i sigurtë se ajo s'mund të kishte bërë ndonjë gjë për të qenë. Vajzat në përgjithësi s'mund të shpikin, dhe ai mendonte se për një mekanizëm grasatimi duheshin njerëz me eksperiencë, mjesh-tër të zot, e jo një vinçiere e re. Duhej menduar pastaj edhe mundësia e montimit të tij, se kjo ishte shumë e vështirë. Me një shikim që i hodhi skicës, e kuptoi se mekanizmi i saj s'mund të montohej.

— Mika, — i tha pastaj, — të grasatosh në mënyrë të mekanizuar një elektrovinç, nuk është e lehtë. Ja, ti ke sajuar ca tuba që kudo t'i vesh, pengojnë manovrimin e krahut të elektrovinçit.

— Ashtu? — pyeti ajo e shqetësuar dhe vësh-troi vizatimet që kishte bërë në letër.

— Ja shiko! — Ai nisi t'ja shpjegonte në ski-cë. Ajo kishte mbërthyer sytë në letër, dhe fytyra herë i skuqej herë i zverdhej.

— Po, ke të drejtë, — tha pastaj e bindur dhe e shqetësuar. Nuk më vajti në mend një gjë e tillë. Çudi si s'më vajti në mend!

— Po të më dëgjosh mua, kot që merresh me të. — tha ai. — Nuk është punë vajzash. Ti e kupton. Ne jemi montatorë dhe s'po ja arrijmë

dot. — Ajo ndënji një çast pa folur. Pastaj i mori skicën nga duart.

— Sikur të mundja t'ja arrija kësaj, — i tha — nuk do të hiqnim vështirësi në lartësitë e elektrovinçeve.

Ajo iku nëpër portën e madhe të hapur përgjysmë, ndërsa ai e vështroi një copë herë. Pastaj mendoi se ajo ishte një vajzë shumë e mirë, po kot që merrej me një punë që s'ishte për të. Do të mendohej t'i mbushte mendjen që të hiqte dorë nga një gjë që s'ishte e zonja ta bënte. Pastaj, e përfytyroi atë midis qiellit e detit duke gratatuar...

— Hë, mo Nasi! — e shkundi Loni. — S'na the a ke dashuruar ndonjëherë. — Nasi u ngrit më këmbë dhe nxori një paqetë «Porti».

— Jo, s'kam dashuruar ndonjëherë, — i tha.

— Je dhe brigadier, ta hajë dreqi, — tha Loni. Nasi nxori një cigare dhe ja futi në gojë:

— Ndize, — i tha! — Dhe mbylle!

Melodia e këngës së atij peshkatarit kishte marrë detin dhe po humbiste tutje në horizont së bashku me konturet e anijeve, ndërsa agimi që ngjitur pas malit, që ende nxinte i përgjumur nën napën e hollë, që s'kishte tërhequr dot nata dhe po lëshohej me vrull tatëpjetë duke u dhënë valëve ngjyrën e bakrit.

— Fillojmë, — tha Nasi. Montatorët u ngritën. Loni hodhi bishtin e cigares në det dhe u afrua i menduar te shokët.

— Të them të drejtën, s'ma merr mendja ta montojmë për dy muaj e gjysmë, — tha. Montatorët, që ende nuk ishin të sigurtë në montimin e atij elektrovinçit, vështruan brigadierin. Ai qëndronte i qetë, i sigurtë në vendimin që kishin marrë.

— Do ta montojmë, Loni, mos ki frikë, — tha Petriti dhe i ra lehtë në supe. Loni rراسi më thellë duart në xhepa dhe ngriti supet me mosbesim...

2 —

Mbi platformën prej betoni u duk një vajzë me pantallona ngjyrë kaki dhe me leshra të prera shkurt. Ajo kishte rراسur duart në xhepe dhe vështronte montatorët që saldonin pllakat e çelikta të këmbëve të elektrovinçit. Kishin bërë goxha punë dhe tani u duhej një vinç. Këmbët e mëdha e të hekurta do të formonin bazamentin e elektrovinçit, dhe ata do ta kishin vështirë për t'i ngritur. I kishin thënë Nasit të shkonte e të tundte një herë atë brigadierin e vinçave për të mbajtur fjalën. Nasi u kishte thënë se përderisa ua dha, duhej ta mbante fjalën, mirëpo vinçi s'po dukej, kështu që ai ishte sulur një herë andej nga depot. Loni se nga humbi ndonjë gjysmë ore dhe u kthye me ca elektroda në duar. U ul mbi një grumbull hekurash duke sharë me zë.

— U ka vdekur mendja këtyre. I thonë një muaj e gjysmë para afatit, mor jahu! Sikur jemi maqina. — Pështyu cigaren dhe ju përvesh punës. Ndjeu se dikush i qëndronte pranë.

— E vëlla, do me më marrë zanatin? — ju shfry. Mirëpo nuk mori përgjigje dhe ngaqë ishte i inatosur hoqi maskën dhe ngriti kokën për t'i këputur ndonjë të sharë. Po u habit që dy hapa larg qëndronte një vajzë me duar në xhepe dhe me një vështrim kureshtar, që se ku e kish parë.

— Ti qenke nuse! — ja bëri dhe mblodhi tre

gishtërinjtë për të treguar çfarë nuseje ishte. Vajza nuk e prishi gjakun dhe filloi ta vështronte me qesëndi:

— E pive konjakun? — i tha pastaj. Lonit ju kujtua se kur qe kthyer në pijetore pasi kishte marrë elektrodën, kishte ndeshur me vajzën, që i kishte thënë se kishte lezet kur pi konjak në kurrriz të punës së shokëve. Ai nuk e kishte bërë të gjatë nga frika e ndonjë fletërrufeje, mirë po ajo s'paskej ndërmend t'i ndahej.

— E, e piva — tha ai i nevrikosur.

— Pandeha se ishe dehur.

— Po ti, ke ardhur të kujdesesh, ë? — qesëndisi ai.

— Nuk e sheh?

— Atëhere ke ardhur për t'u martuar, — tha ai për ta hequr qafe, — po jo me mua, se unë jam namuzlli dhe nuk m'i ka qejfi çupërlinat me pantallona. — Vajza këtë radhë u skuq, ndënjë një çast pa ditur ç'të bënte, pastaj u kthye me rrëmbim.

— Ngadalë, ngadalë, — u dëgjua zëri i Nasit që vinte drejt tyre. — Qenke ti? Ai e vështroi i habitur në sytë e saj ngjyrë hiri dhe ndjeu t'i lëvizte gjaku me shpejtësi. Edhe ajo sikur u hutua.

— Po, unë jam, — tha pastaj. — Ju e montoni atë elektrovinçin?

— Po, ne e montojmë atë elektrovinçin.

— Më dërguan këtu, — tha ajo duke u bërë ballë vështrimeve të montatorëve.

— E ç'do të bësh ti këtu? — u hodh Loni.

— Të punoj me ju, — tha vajza e qetë.

Loni i qeshi mu në fytyrë. Ju afrua Nasit i sigurtë që do ta bënte vajzën të ikte me vrap nga turpi.

— Kaq i ke krahët ti? — i tha asaj duke i treguar krahët e shëndoshë të brigadierit. Vajza e kuptoi se ç'donte të thosh ai, megjithatë nuk e prishi gjakun. I hodhi padashur një vështrim kraheve të saj që para muskujve të fortë të Nasit dukeshin si cingla dhe tha duke vënë buzën në gaz:

— Unë i kam dhjetë herë më të fortë se ju të gjithë bashkë.

Mbi platformë plasi gazi. Vinte një vajzë aty, një vajzë e dobët dhe u thoshte se ishte dhjetë herë më e fortë se ata. Edhe Nasi qeshi, megjithëse e kuptoi ku e kishte fjalën ajo. Puna ishte se mon-tatorët, si njerëz të veçuar, nuk i njihnin të gjithë vinçierët e aq më pak vajzën që punonte andej nga depot e portit larg platformës së tyre të betontë. Dhe veç Nasit nuk çonte njeri tjetër puna aty. Vajza ishte aq e sigurt në fjalët që kishte thënë, sa në fund të fundit ata duhej patjetër ta besonin se ajo ishte dhjetë herë më e fortë se të gjithë ata bashkë. Dhe qeshnin. . .

— Po mbylleni, xhanëm! — thirri Nasi dhe ju drejtua vajzës: — Mika, ty të kanë dërguar me vinç?

— Po, — tha ajo.

— Pse vinçiere je ti? — e pyeti Petriti.

— Po.

— Çudi!

— E pse çudi?

— Se s'ta mbush syrin prandaj, — tha Loni. Ai ishte nga ata që nuk besonin shumë në inisiativën e të rejave të portit të Durrësit: «Luftë kundër konceptit: Porti i burrave dhe i burrave të fuqishëm», e cila po përhapej dhe në portet e tjera.

— Ta shohim, Loni, — ndërhyri Nasi, që po vriste mendjen nëse duhej të kërkonte një vinçier tjetër apo të mbante atë. — E kanë dërguar për të na ndihmuar.

Loni tundte kokën, ndërsa Petriti tha se ashtu ndryshonte puna. Megjithatë montatorëve u pëlqeu Mika, një vajzë e mirë, që nuk i mernte për keq shakatë. Dhe ju përveshën montimit...

3

— Më majtas, edhe pak majtas, aty!.. aty, moj! Mundohu ta ulësh Ule, ta hajë dreqi! — thërriste Nasi duke ja bërë me dorë vinçieres, e cila mundohej të vendoste mbi bazamentin e elektrovinçit një bllok hekuri.

— Nuk ulet, Nasi! — tha vajza e lodhur. — E pengon edhe era!

— Ngrije lart

Ajo e ngriti.

— Do burra kjo punë, — tha me gjysmë zëri Loni, që punonte aty afër, — e jo çupërlina me pantallona. Nasi ndezi me vështirësi një cigare. Ju afrua vinçit dhe i tha Mikës të shlodhej pak. Ajo u mbështet në sedilen e kabinës. Mbi platformë ishin montuar katër këmbët e elektrovinçit që formonin bazamentin dhe kishte filluar puna në lartësi. Kishin filluar t'u dëlnin edhe vështirësitë e para. Nasi hodhi bishtin e cigares dhe vështroi Mikën.

— E provojmë dhe një herë, — i tha me një shprehje mosbesimi në fytyrë. Mundohu ta mbash majtas!

— Do të mundohem, Nasi. — tha ajo. Atij ju duk sikur do t'ja shkrepse të qarit. Megjithatë blloku i hekurt duhej të vendosej. Vinçierja e afroi mbi bazament duke u munduar të llogarisë forcën e erës.

— Ule! — thirri Nasi. Ajo filloi ta ulte. Era e detit e tundte lehtë-lehtë dhe e vështirësonte uljen mbi bazament. Asaj ju mbush i tërë trupi me djersë. Era e shtynte gjithmonë nga e djathta.

— Majtas, Mika! — thirri Nasi. Ajo u mundua ta mbante majtas. Blloku filloi lëkundje të gjata. Befas çiku bazamentin duke lëshuar një tingull metalik, që i ngriti më këmbë montatorët.

— Ngrije! — thirri Nasi. Hekuri i shtyrë majtas po kthehej më me forcë duke rrezikuar përplasjen me bazamentin, i cili mund të rrëzohej. Montatorët e vështronin të shqetësuar. Edhe Nasi.

— Do ta përplasë, — tha Loni.

— Ta hajë dreqi! — shau Petriti.

— Ngrije, Mika! — Hekuri filloi të lëvizte drejt bazamentit dhe montatorët pritën përplasjen e fortë.

— Ngrije!

— Fajin e kanë ata që na dërgojnë vajza, — gjeti kohë të thoshte Loni. Nasi tundi kokën në shenjë pohimi. Duhej të mos kishte pranuar që në fillim, mirëpo s'do t'i jepnin tjetër. Pastaj... se si i vinte që kishte filluar të punonte me të. Që kur kishte ardhur ajo në brigadë, ishin miqësuar shumë. Madje kishin dalë dhe shëtitje. Ajo i dukej vajzë e guximshme, mirëpo ai mendonte se në montim nuk mund të punojnë vajza. Në fund të fundit, ai nuk mund të pengonte punën për

hir të ndjenjave që ushqente për të. Nasi u shkëput nga këto mendime dhe vështroi bllokun e hekurt që i afrohej me shpejtësi bazamentit. Me siguri tani do të përplasej me të dhe do ta shembte përdhe. Do të shembte punën e tyre të një jave. Ç'kishte bërë? Ai mbylli sytë. Kush i dëgjonte montatorët tani? Befas dëgjoji thirrje gëzimi:

— Të lumtë, Mika! — Ai hapi sytë. Blloku i hekurt qëndronte pezull mbi bazament dhe po ulej me shpejtësi. Pastaj e ngadalësoi shpejtësinë dhe u ul butë mbi të. Nasit i erdhi inat që nuk e pa dot si kishte ndodhur. Mbase aty do të kishte rast ta njihte vajzën më mirë. Mika kishte bërë një manovrim të shpejtë për habi të të gjithëve.

«Kjo ka të bëjë me guximin e saj» — mendoi ai — «dhe jo me zotësinë». Era e detit më në fund ishte mposhtur. Nasi ndezi një cigare. Për atë ditë puna kishte mbaruar.

Mika pastroi kabinën dhe zbriti poshtë. Montatorët ishin larë dhe po iknin nëpër platformën prej betoni, ndërsa ajo ju afrua Nasit, që po vishte pulovrin.

— Nasi, unë e përpunova atë mekanizmin, — tha ajo me ndrojtje. Ai drejtoi trupin. Pulovri mbeti i veshur përgjysmë. Vështroi Mikën me një farë habie, pastaj vazhdoi ta vishte.

— Pandeja se do ta kishe harruar, — i tha.

— E si mund ta harroja, Nasi! Neve vinçierëve, do të na ndihmojë shumë.

«Kurse neve, montatorëve do të na hapë punë» — mendoi ai. Ç'i kishte shkrepur dhe kësaj! Kishte dëgjuar se shumë vajza kanë bërë shpikje dhe pandehte se edhe aty mund të bëheshin. E si

mund t'i besohej mekanizmit të saj? Megjithatë ai i tha me gjysmë zëri t'ja jepte.

— Do të montohet në lartësi, — shpjegoi ajo. — Grasetimi do të bëhet nga kabina pa qenë nevojë të lëvizësh nëpër elektrovinç. Dhe nuk do ta pengojë manovrimin. — Nasi e vështroi një copë herë skicën, pastaj ja ktheu:

— Tani e gjete, moj Mika, — ja nisi ai. — Ti e shikon se jemi të mbytur në punë.

— Po kjo nuk do të hajë kohë, — tha ajo.

— Puna nuk është tamam ashtu. Ne na duhet ta dorëzojmë për dy muaj e gjysmë, më kupton? Sado besim të kemi në forcat tona, nuk jemi të sigurtë, se nuk kemi montuar kurrë një elektrovinç në dy muaj e gjysmë. Ç'ke ti. Ta dorëzojmë këtë dhe në tjetrin vendosim mekanizmin tënd.

Mika e kuptoi se ai po e hiqte qafe me mirësjellje dhe i erdhi inat. Kur i kishte hyrë punës për mekanizmin ajo kishte menduar se Nasi do ta pranonte me siguri. Ajo që e bindur se i vetmi që mund ta montonte mekanizmin në lartësi që ai. Nasi që ndruhej kur fliste me të. Mirëpo, ai po e hiqte qafe. Megjithatë, ajo vendosi të ngulte këmbë gjersa t'i mbushte mendjen.

— Sidoqoftë unë nuk tërhiqem, — tha ajo.

— Pse të mos e montojmë pas dorëzimit të elektrovinçit, ç'na kushton? — lëshoi pe ai.

— Jo. Mekanizmi është më lehtë të vendoset gjatë montimit. Ti e di më mirë se unë.

Ai e vështroi i menduar. Si montator e dinte më mirë se kushdo si mund të montohej mekanizmi e sa punë mund t'u hapte, po si brigadier ai dyshonte në zotësinë e saj. E çfarë mund të nxirrte ajo me disa tuba? Ai mendoi se nuk ja vlente barra

qiranë të merrej me të. Bile duhej t'ja priste copë. Për të mekanizmi ishte një vrimë në ujë.

— Mos ngul këmbë kaq shumë, — tha ai. — Nuk ja kemi kohën. Na duhet ta dorëzojmë pas dy muajsh. Lëri tani këto.

— Këto m'i thua si montator apo si brigadier? — e pyeti ajo, dhe në zërin e saj u ndie një notë ftohtësie.

— E ç'rëndësi ka?

— Ka rëndësi, — tha prapë ftohtë ajo. — Po ka. — Ajo filloi të inatosej. Qendrimi i tij i ngrinte nervat. I dukej sikur ai nuk e besonte, nuk besonte asgjë të saj. — Megjithatë unë do t'ua them shokëve. — vazhdoi ajo. — Do t'ua them edhe nga nisem unë që e propozoj një gjë të tillë. Ajo u kthye pas dhe iku nëpër platformën prej betoni. Nasi e vështroi një copë herë. Ajo largohej me çapa të shpejtë dhe me supe që i dridheshin. Pastaj, ai e rrëshqiti vështrimin mbi bazamentin e elektrovincit që kishte hapur këmbët e mëdha e të hekurta si të qe një gjigand përrallash.

— Eh, or mik, — psherëtiu. — Një vajzë kërkon të ta ulë hundën. Një vajzë që nuk mund ta ndal dot...

* * *

Propozimi i Mikës ndezi furtunën në një kohë kur moti dukej i mirë. Montatorët e dëgjuan në heshtje. Disa pinin cigare, dhe asaj i dukej se atyre aq u bënte.

— Ju nuk e kuptoni, — tha ajo, — as që doni ta kuptoni! E di ç'do të thotë të ngjitesh shtatëdhjetë metra dhe të grasatosh?

— Ne e kuptojmë shumë mirë, — tha Loni. — Po ja që Nasi është brigadier, ja që Nasi ua di të gjitha huqet elektrovinçave. Ja që ai e njeh me dhëmbë e dhëmballë edhe këtë. Prandaj, shoqja Mika, do të bësh mirë ta hedhësh në det atë copë letër.

Mika ishte bërë shumë nervoze.

— Puna është se unë nuk kam një copë letër, po disa copa hekurash që janë një mekanizëm. Po nuk më bëhet vonë për të. Unë nuk e dija që ju prisni vetëm fjalën e brigadierit. Ju nuk vendosni dot pa të, nuk keni mendimin tuaj. Më vjen keq që nuk e dija më parë.

— Kurse unë sinqerisht po mallëngjehem, — qesëndisi Loni.

— Sigurisht, se ti je bishti i tij! — tha ajo.

Nasi kishte heshtur gjer në atë kohë, po pastaj i hipi gjaku në kokë. Ajo po e zgjaste si shumë. Atij nuk ja priste mendja se ajo do ta tepronte aq. Mirëpo në radhë të parë elektrovinçi duhej dorëzuar ditën e zotimit. Megjithatë, vendosi të mos fliste. Mika filloi të vizatonte me një shkumës në një pllakë çeliku. Disa nga montatorët ju afruan ta shohin. Asaj ju ndez një fije shprese.

— Nuk ka ndonjë vështirësi, — tha ajo me zell. — Dhe nuk kushton shumë.

— Fjala qenka për ca tuba, — tha një montator.

Nasi e kishte kuptuar më mirë nga të gjithë mekanizmin e saj, megjithatë e vështronte si diçka të pavlefshme. Vuri re se Petriti e ndiqte shkumësin e saj me një kurreshtje fëmije, dhe ajo që e çuditi më shumë ishte se ai jepte shenja se skica ishte shumë e mirë. Petriti aq ishte thelluar në vizatimin e Mikës sa thirri papandehur:

— Po ky është sukses, Nasi! Ti vetë këto kohët e fundit e ke vrrarë mendjen për të mekanizuar gratimin në lartësi. Ky është tamam mekanizim!

Nasi heshtte dhe me këtë heshtje që Petriti e njihte si bukën që hante, kishte shprehur mendimin e vet.

— Nuk pranon, Nasi?

«Jo, — thosh heshtja e tij. — Nuk pranoj». Petriti nuk e gjeti të arësyeshme ta pyeste përse nuk pranonte.

— Megjithatë ky mekanizëm duhet përkrahur. — Ai u kthye nga shokët. Sytë e montatorëve u kryqëzuan mbi fytyrën zeshkane të Petritit. — Unë mendoj që ta vendosim. Sytë e montatorëve filluan bisedime të heshtura. Megjithatë Nasi nuk pranonte bisedime.

— Nasi e di shumë mirë punën tonë, — tha Loni dhe deshi të shtonte akoma, po ndjeu sytë zhbironjës të Petritit. Dhe e mbylli. Pastaj sytë e Petritit ju kthyen brigadierit.

— Kështu është, Nasi? — e pyeti më në fund. Ai nuk u përgjigj.

Të tjerët heshtnin. Petriti e vështronte sikur kërkonte të gërryente diçka në trurin e brigadierit.

— Mund të flasësh edhe pa më vështruar ashtu, — tha Nasi. — Ti duhet ta kuptosh vetë.

Ai sigurisht e kuptonte vetë. Nuk e vështroi më. Nasi ktheu shpinën dhe vazhdoi punën. Montatorët e ndjenë se ai ishte fyer nga mosbesimi që tregonin ndaj tij.

Dhe vështronin Nasin, që e kishin shok, që e donin. Atë vështronte dhe Mika, ajo vinçierja që kishte dëshirë të punonte me të. Ajo që, kur e ki-

shin pyetur Nasin në kishte rënë ndonjëherë në dashuri, atë kishte përfytyruar midis kaltërsive.

— Ti nuk ke besim te Mika, — tha Petriti hapur.

— T'u desh shumë ta kuptoje?

— Po, shumë, — tha Petriti i habitur dhe i zemëruar. — Se nuk ma hante mendja që ti të mos kishe besim te vajzat. Ky ishte rasti i parë që të vuri në provë. Megjithatë nuk do ta besoja kurrë.

— Nuk të lutet njeri ta besosh. Po ta them vetë. Që të montosh mekanizmin e saj, duhet kohë.

— S'është tamam ashtu, Nasi, — se kush tha.

— Është që ç'ke me të. Duhet kohë. Do të bëhen modifikime, do të korrigjohen gabime, duhen gjetur materiale se nuk është fjala vetëm për ca tuba, po për një mekanizim të punës. — Nasi fliste shpejt e shpejt dhe i merrej fryma. — Ajo është një punëtore shumë e mirë po... Kjo na takonte neve që ua dimë të gjithë vinçave, e jo vinçierëve.

Mika e skuqur në fytyrë duke i mbajtur me zor lotët sepse po i mbushej mendja që propozimi i saj do të fluturonte në det, u hodh ta ndërpriste:

— Ju betohem, shokë... Nuk e merrni me mend sa frikë është kur grasaton atje lart... Sidomos kur fryn erë. Oh! Është e tmerrshme!..

— Mos u dëshpëro, — i tha një montator — ndoshta do të gjejmë ndonjë rrugë.

— Po humbasim kohën kot, — tha Nasi.

— Në qoftë se ti nuk do ta marrësh përsipër mekanizmin, do ta montoj unë, — deklaroi Petriti.

Nasi nuk e priste këtë. E dinte që ai nuk do ta montonte dot. E njëjtte aftësinë e çdo montatori. Megjithatë nuk e priste. E ç'të thosh? Ai mendoi se

nuk i kishte mbetur asgjë për të thënë. Le të bënin si të donin. Po ta aprovonte byroja teknike, le ta montonte Petriti. Montatorët ishin në një mendje me Petritin. Dhe ata që ndruheshin, thanë ta provonin një herë. Loni as që pranoi të thoshte ndonjë fjalë.

— Nuk do të na hajë as dy ditë kohë, — i tha Petriti Mikës kur mbaruan punën.

— Kështu mendoj dhe unë, — ja ktheu ajo duke vështruar Nasin, që po largohej me pulovrin e hedhur supeve. Mika tani ishte qetësuar. Vendimi i Petritit e kishte ngazëlyer, po diç e brente për Nasin. Se ai ishte nga ata djem që nuk tërhiqen kurrë para vështirësive. Diç ndjente për Nasin.

— Nuk u sollëm dhe aq mirë me Nasin, — tha ajo duke ndjerë të skuqej në fytyrë.

— Ja bëmë mirë, — tha Petriti. — Megjithëse montimi i mekanizmit është i vështirë.

— Kjo është e vërtetë...

— Megjithatë Nasi nuk është ashtu siç e pa-ndeh ti, — vazhdoi ai. — Atë nuk e shqetëson vështirësia e kësaj pune. Oh, sa për këtë ai ka borxh ta bëjë edhe vetëm, po ai nuk e pranoi se ishte ti ajo që e bëri propozimin. Dhe ti je një femër.

— E di, — tha Mika.

— Unë nuk e dija.

— Prandaj mua më vjen keq për të, — tha Mika.

— Doemos, — tha ai. — Megjithëatë ti nuk duhet të dëshpërohesh. Mekanizmin do ta montoj unë.

— Nuk do ta kesh të lehtë.

— Po. — Petriti uli kokën. — Megjithatë nuk besoj që Nasi të më shohë nga poshtë me duar në xhepe, — shtoi pastaj.

Kur hyn vjeshta e tretë, deti fillon nga tekati e veta. Fryn erë e fortë që rrëmben cifla të lëngëta nga kreshtat e dallgëve dhe i sorollat pastaj nëpër qytet. Për montatorët nisin ditë të vështira, ndërsa për peshkatarët shqetësimet. Nasi ka ardhur mbi platformën prej betoni dhe vështroi i menduar elektrovinçin që tashma ka hedhur atë shtatin e tij gjigand e të hekurt.

«Nesër» — thotë me vete. Nëpër trup i kaloi një valë të rrënqethurash. Në këmbët e elektrovinçit ishte lënë si i harruar një bllok tubash gjithë gunga e shtrembërime. Ai e vështroi me përçmim.

«E përse mund të hyjë në punë kjo shkarra-vinë?», — mendoi. Ai bllok tubash ishte mekanizmi, i cili dergjej i heshtur nën shiun e imët, që kishte nisur të binte. Nasit i erdhi t'ja ngjeshte me shqelma gjersa ta copëtonte e ta flakte tutje në det.

«Na doli dhe ky gungaç!», — shau. «Ky Rigo-letto i hekurt!» — U kënaq që i gjeti një nofkë të tillë se atij nuk mund t'ja mbushte mendjen mekanizmi. Sikur t'i vihej ai kësaj pune, do të nxirrte një mekanizëm të shkëlqyer, bile edhe sipas skicës së Mikës. Atij nuk mund t'i mbushej mendja se mund t'u hynte në punë «gungaçi».

«E çfarë mund të nxjerrin tjetër duart e një vajze», — mendoi. «Të tillë gungaçë e asgjë më tepër». Ky ishte fruti i punës së montatorëve pa të. Ato ditë që ishte aprovuar mekanizmi ai nuk kishte qenë aty. Kish shkuar për të përgatitur ca materiale që nevojiteshin për montimin e elektrovinçit.

«Le ta bëjë Petriti,» — kishte menduar. «Dhe ajo...». Nuk donte t'ja përmendte emrin Mikës. Ai nuk e dinte se ajo e priste çdo ditë me vështrimin nga porta e hekurt. Mirëpo ai nuk kishte vajtur. I vinte inat që e kishin besuar aq shumë Mikën. Bile i vinte inat edhe që atë ditë ishte ngritur që në mëngjez për të ardhur posaçërisht për të aty mbi platformë. Pse kishte ardhur? Për të parë se ç'kishin kollandrisur ata? Ishte ditë pushimi dhe platforma kishte mbetur e zbrazur. Vetëm elektrovinçat vështronin që nga retë e ngrysur me atë pamjen e tyre krenare. Nasi ishte ngritur dhe kishte ardhur mbi platformë për të parë mekanizmin. Donte ta shihte nga afër, larg syve të të tjerëve. Mirëpo, sapo u gjend pranë tij dhe i hodhi vështrimin e parë, ndjeu neveri për të. Ai ishte gjithë gunga e tuba si një oktapodh i plagosur. E kishte marrë me mend se do të kishin bërë ndonjë shtrembanik. Mirëpo atë e kishin aprovuar...

Nasi i hodhi dhe një vështrim «gungaçit». Në trupin e tij të shtrembër ndrinin bulëzat e shiut. Ato qëndronin një çast pa lëvizur, pastaj zinin e ndiqnin njëra-tjetrën si të ishin fëmijë të gëzuar. E tërhoqi ajo pamje. Këtë radhë atij nuk ju duk dhe aq i shëmtuar. Befas, ndjeu frikë. Ndjeu frikë se mos i hynte në zemër ai «gungaç» se atë e kishte bërë ajo ose e kishte menduar ajo. Ju afrua më pranë dhe filloi ta vështronte me kujdes për t'i zbuluar ndonjë të metë. Ai ishte i bindur se të metat duhet t'ishin të panumërta... Po kanalet e grasatimit funksiononin në rregull. Edhe depua e grasos ishte në rregull.

«Çfarë gjëje mund të mos ketë në rregull?», — mendoi. Ai nisi ta vështronte nga të gjitha anët.

Duhej medoemos të kishte ndonjë të metë. Filloi t'i vinte çudi se përse i qe dukur aq i shëmtuar. Teknikisht nuk po i gjente ndonjë të metë, vetëm se ishte i shëmtuar.

«Mbase nuk do të funksionojë në rregull», — mendoi. Preku me dorë pompën e grasos, po pastaj e hoqi menjëherë sikur ta kishte djegur.

«Edhe pompa duhet të jetë në rregull».

Nasi dëgjoi hapa mbi platformë. U largua nga mekanizmi dhe filloi të vështronte elektrovinçin. Ai dukej sikur i buzëqeshte. Nën tufën e rrezeve të diellit që kishin depërtuar nëpër një copë qiell, trupi i tij llamburiste.

«Ti nuk mund të mos më dukesh i bukur, o mik» — tha me mend. Hapat u larguan në një drejtim tjetër, megjithatë ai vendosi të ikte që andej. Kishte frikë mos e gjenin aty. Nuk duhej ta gjenin aty. Ai kaloi para mekanizmit dhe nuk mundi të përmbante veten pa e vështruar edhe një herë.

«Nesër do të na hapësh punë, o gunçaç!» — tha me vete.

* * *

Nasi mendoi të kthehej në ndonjë bar të pinte një konjak. Do t'i bënte mirë një konjak. Mori rrugën e gjerë buzë detit.

Aty ishte një bar i qetë ku nuk kishte shumë njerëz. Hyri nëpër derën e madhe dhe ju lut banakieres t'i mbushte një gotë.

— Dopolio? — e pyeti ajo.

— Si të duash.

Ajo ja mbushi dopio. Nasi piu mengadalë. Kër-koi dhe një paqetë cigaresh.

— Porti, — i tha. Ajo i dha një «Porti». Ai vuri një cigare në gojë dhe pagoi paratë.

«Sidoqoftë ata arritën ta ndërtojnë mekanizmin», — mendoi, duke dalë në rrugën buzë detit. Vetja ju duk i vetmuar. Sikur kishte mbetur pa shokë, pa brigadë, pa...

«Ta hajë dreqi!» shau me vete. Qëndroi para një vitrine me xhame të lagura. Qielli ishte errësuar, dhe përsëri ja kishte nisur një shi i imët.

«Do ta kenë vështirë ta montojnë tridhjetë metra lart», — mendoi. Nëpër turbullirën e xhamit befaz vuri re Mikën, që ecte me hapa të shpejta. Ndjeu të rrënqethej. Papritur ajo qëndroi dhe u kthye nga ai. Dhe ajo e kishte vënë re, po nuk vendoste dot t'i fliste. Pastaj bëri dy çape nga ai dhe i thirri:

— Nasi!

Ai ktheu kokën. U mundua të lëshonte një buzëqeshje, po nuk ja arriti dot. Ajo dukej e tronditur.

— Si je? — mezi e pyeti ai dhe filluan të ecnin në rrugën buzë detit. Në breg po ndërtohej një mur i gjatë me gurë të bardhë si të qe një digë për të penguar vërshimin e dallgëve në qytet. Megjithatë, dallgët mezi zvarriseshin deri te muri. Nasi vështronte detin. Nën shiun e imtë që binte, ai dukej si një masë e madhe e zgërlaqur, ngjyrë hiri, që zvarrisëj i nënshtruar në këmbët e murit të bardhë. Dukej i mpirë, sikur ta kishin sharë rëndë e s'i kishte mbetur gjë tjetër veç të fshihte zemërimin e vet.

— Si kalove andej? — e pyeti Mika si bënë një copë rrugë. Atij i erdhi mirë që e pyeti.

— Mirë, — nxitoi të përgjigjej duke ndjerë se po skuqej. Ai nuk duhej të qëndronte në heshtje. E kuptoi që ajo kishte një dëshirë të madhe t'i fliste për atë «gungaçin» e vet. Ajo nuk e dinte se ai e kishte parë, kishte këmbyer dhe nja dy fjalë me të. Bile i kishte këputur dhe ndonjë të sharë. Prandaj vajza donte t'i thoshte se gjatë kohës që ai kishte qenë në oficinë për materialet, e kishin ndër-tuar. Mirëpo ajo ndruhej. Fundja ç'rëndësi kishte? Ata e ndërtuan dhe pa të. Megjithatë, Nasit i vinte mirë që ajo nuk i qëndronte me turinj.

— Nasi, ne e ndërtuam atë mekanizmin, — ja nisi ajo më në fund.

— E di, — foli ai, — «atë gungaçin» — deshi të thoshte po u pendua që e hapi veten.

— Nga e di?

— Dua të them e marr me mend — e ndreqi ai.

— Nesër do ta montojmë, — tha ajo duke u munduar të mos e fyente. Ai thithi fort cigaren dhe pastaj e flaku në rrugën e lagur. Bënë disa hapa pa folur. Ai e dinte që do ta montonin të nesërmen. Do ta montonte Petriti. Megjithatë ecte pa thënë gjë. Befas qëndruan. Qëndruan pa pasur ndonjë arësye. Ajo e vështroi thellë në sy. Me ata sy që dukeshin si dy copa deti në mot me shi. Ja si ai deti matanë murit.

— Nasi, do të vish nesër? — e pyeti ajo.

Ai mendoi se kjo ishte e vetmja pyetje që mund t'i ndante. Mendoi grupin gazmor të montatorëve me atë mekanizmin «gungaç» mbi supe. Sidoqoftë, ata e kishin ndërtuar pa të. Atij përsëri ju duk se kishte mbetur vetëm, megjithëse nuk kishte as tri ditë që ishte ndarë nga ata.

— Si thua, Nasi, do të vish? — e pyeti prapë ajo. Ai e kuptoi se Mika priste me shpresë përgjegjen e tij.

— Po, — tha ai.

5.

Nasi thithte cigaren me vështrimin nga lartësitë. Aty ishte ngjitur Petriti me mekanizmin, i ndjekur nga vështrimi i shqetësuar i Mikës dhe i montatorëve.

— Mos u bëj merak, Nasi, — dëgjoi zërin e Lonit nga pas, — s'ka për ta montuar dot.

Nasi thithi fort cigaren pa e ndarë vështrimin nga lartësitë. Aty Petriti kishte nisur një betejë të pabarabartë. Një njeri në lartësi tridhjetë metra dhe «gungaçi» i hekurt i varur në një ganxhë vinçi. Dhe era që shfrynte e inatosur. Atij i dukej se çdo gjë bëhej në ritmin e një melodie montimesh. Gjithnjë e ndjente atë melodi, kur u ngjitej lartësive. Ajo tingëllonte e fortë, e fuqishme. Nasit i pëlqente shumë, i ngjallte ndjenja, megjithatë nuk kishte mundur kurrë ta fërshëllente.

«S'ka për ta vendosur dot», — tha me vete pa e ndarë vështrimin nga Petriti. Para se të ngjitej, Petriti e kishte vështruar gjatë. Pastaj kishte vënë buzën në gaz dhe kishte filluar të ngjitej. Nasi kishte heshtur. Megjithatë, vështrimin nuk e kishte hequr nga elektrovinci ku ngjitej ai. Edhe ajo melodia nuk i ndahej.

«S'ka për ta vendosur dot.»

Megjithatë, melodia sa vinte e ngrihej më e fortë, e gjallë, e bukur duke përfshirë nën forcën e vet dhe qiellin, dhe detin.

— Mika ka bërë një gjë të mirë, — se kush tha nga montatorët.

«Një gjë të mirë», — mendoi ai, — një «gungaç të mirë». Sikur të montohej atë ditë mekanizmi nuk mbetej shumë punë. Pas një jave elektrovinçi do të lëshonte uturimën e tij të parë. Ai ishte i sigurtë për këtë. Domethënë edhe dhjetë ditë para afatit. Pas montimit të mekanizmit çdo gjë ishte e thjeshtë.

Muzgu po zbriste pa u ndjerë mbi shpatullat e vinçave dhe të montatorëve. Ai mendoi Mikën, që qëndronte aty lart duke u munduar të zhbironte shiun, që nisi të binte me vrull.

— Edhe ky mungonte, — se kush tha.

Nasi dhe të tjerët kishin disa orë që mbanin kokën lart, aty ku luftonte Petriti. Dhe ishte i vetmi front ku nuk mund të luftonin shumë vetë. Nga deti frynte erë e fortë, që rrezikonte çdo manovrim të Petritit. Ndërsa «gungaçi» i shtonte gjithnjë lëkundjet.

— S'ka për ta montuar dot, — tha njëri.

— Unë e kam thënë që në fillim, — tha Loni. Megjithatë, ai nuk e hiqte vështrimin nga mekanizmi.

— Me gjithë mend s'ka për ta montuar dot? — belbëzoi Nasi. Ai e dinte që do ta kishte të vështirë, po tani që e shihte duke luftuar aty i vetëm, i erdhi keq. Tani dëshironte me gjithë shpirt që Petriti të mundte vështirësitë dhe t'i jepte fund asaj pune. Dhe pas një jave ata do të dërgonin elektrovinçin. Se montimit po i vinte fundi. Vetëm ai mekanizëm...

«Mbase Mika nuk e ka bërë dhe aq keq», — mendoi.

— Ti i di më mirë këto punë, Nasi, — dëgjoi zërin e Lonit.

Ai e vështroi ftohtë. Ftohtë e vështroan dhe të tjerët. Pastaj, vështrimet i ngjitën lart sikur të donin ta mbanin Petritin të mos rrëzohej.

— Sikur të lidhet me litar ndonjëri nga ne, — tha një montator.

— Edhe kjo na duhet.

— Nasi, si thua ti? — e pyeti ai montatori.

Nasi u rrëqeth. Ata po e pyesnin si mund të vendosej aty mekanizmi. Ai «gungaçi». Oh, sa mënyra dinte ai!

— Hë, Nasi!

Nasi nuk tha gjë. Vetëm thithi fort cigaren, të cilën e flaku pastaj në det si të hidhte diçka që duhej flakur prej kohe. Në të vërtetë bishti i cigares po i digjte gishtërinjtë, po atij i dukej sikur po i digjte diçka përbrenda... Pastaj, bëri një gjest me dorë. Një gjest që montatorët e njihnin mirë. Dhe sytë filluan t'u shkëlqenin në muzgun e lagur. Po më fort ndrinin ca sy atje lart pas xhamit të kabines së vinçit. Seç ndjeu ajo kur e vështroi të ngjitet nëpër hekurat e lagur e të ftohtë. Ju duk sikur filloi të shkonte te ajo, megjithëse i ndante një hapësirë e frikshme. Po ai ngjitej dhe, sado që nuk vështronte andej, i ndjente sytë e saj. Atij i duhej të arrinte patjetër te ajo. Ashtu i thoshin sytë e saj, që kishin filluar të shihnin turbull nga lotët. Dhe sytë e montatorëve. Dhe sa fort dëgjohej ajo melodi.

Nasi arriti aty ku luftonte Petriti. Vuri re se ai ishte këputur fare. Edhe Petriti e kishte ndjekur me vështrimin e vet.

— Ma lër mua, Petro, — i tha.

Petriri i hodhi një vështrim të rraskapitur e të turbullt, po të qeshur. Atë kohë ai kishte vendosur mekanizmin. . .

— Bëre mirë që erdhe, Nasi, — tha ai duke u dridhur dhe duke u munduar të vinte buzën në gaz. — Unë nuk zbres dot më. Jam shumë i lodhur. Po të zbres, mund të më këputen duart dhe të bie poshtë.

— Do të zbresim bashkë, — tha Nasi duke vështruar «gungaçin», e vendosur. Ai nuk ju duk i shëmtuar, ai ndrinte nën ngjyrat e muzgut si të ishte një pjesë e pandarë e gjigandit të hekurt, të cilin po arrinin ta montonin në një kohë rekord. . . Pastaj, sytë i hodhi nga Mika:

— Ule! — thirri me zë të fortë që oshëtiu në gjithë platformën. . .

PËR SHOKUN

Aty ndanë udhës priste dhe një vajzë. Ndërsa dy malësorë ishin ulur në shkallinën e vetme të agjencisë. Njëri po dridhte cigare, ndërsa tjetri mundohej të fuste në një trastë leshi një kuti këpucësh. Atij që dridhte cigare i ishin ngritur nervat me mundimin e kotë të shokut.

— Po ti lenë kutinë, hej burrë! Futi qashtu pa kuti, — tha ai kur ju sos durimi dhe lagu kartën e cigarës me gjuhë.

— Jo, or, se duhet kutia.

— Po mbaje në dorë atëhere.

Vetëm ata të tre prisnin në agjenci. Vajza, si ndenji ca në parmakët e urës së Fanit, ju afrua atyre. Frynte erë e fortë aty te ura, erë që sillte lumi nga gryka dhe që përplasej pastaj brigjeve ku qe ngritur qyteti.

Ai me kutinë e këpucëve u mat të hapte muhabet me vajzën. Më në fund u mërzit me kutinë dhe vendosi ta mbante në dorë.

— Prej kah të kemi, oj cucë? — i tha vajzës.

— Këndeje jam, mirditore.

— Allahile, po prej kah, oj cucë?

— Përqark, — u përgjegj ajo pa përcaktuar gjë. Nuk e kishin zakon cucat të jepnin përgjegje

të tillë, prandaj të dy malësorët e vështruan me një farë habie dhe inati.

— Prej katunit vjen, a? — pyeti ai tjetri që dridhte cigare dhe që posa e kishte ndezur.

— Jo, prej uzine. Jam punëtorë.

— Aha! — Ai me kutinë e këpucëve e vështroi me kërshtëri. E kishte marrë për mësuese, po u çudit që ishte një malësore, punëtorë në uzinë. Se kishte dëgjuar që shumë vajza kishin filluar të punonin në uzina, të cilat ndërtoheshin në këmbë të maleve.

— A ka cuca të tjera aty ke ju? — pyeti ai.

— Pothuej të tana jan cuca. Uzina asht e re. E ku me i gjetë punëtorët?

— Allahile!

— Posi! Mos don me pru edhe ti ndoj cucë te na?

— Jo, zoti na ruejt! — murmuriti malësori duke u hedhur dorën mustaqeve të dendura e të thinjura. Pastaj u ngrit në këmbë. Te cepi i urës u duk një maqinë...

Vajzës nuk i bëri dhe aq përshtypje gjesti i malësorit. Edhe i ati, Pali, ashtu kishte qenë. Me një tufë mustaqesh nën hundën e krusur dhe me një palë vetulla të dendura të harkuara mbi një rrudhë të thellë. Ndaj dhe ra në mendime të thella tek rrinte pështetur në sedilen e maqinës. Se kishin ndodhur shumë gjëra në jetën e saj. Ndaj dhe i kujtoi ajo me vështrimin e hedhur në luginat e mbështjella me një tis mjegulle.

... Një ditë në shtëpinë e tyre kishte vajtur i ati i Nikës. Pali e ftoi në dhomën e miqve dhe i

vuri raki përpara. Por i ati i Nikës s'kishte vajtur për raki.

— Kur do ma japësh cucën, or Pal? — ja kishte nisur ai. — Ajo tash asht pjekë.

Pali u myrënjt në fytyrë. Rrudha nën vetulla ju thellua më shumë. Kishte ndërmend ta dërgonte në kurs të bijën, për të punuar në uzinë. Kështu i kishte thënë sekretari i partisë. Se uzina kishte nevojë për punëtorë. E bija e donte dhe e nderonte shumë. Plaku Pal e dinte mirë këtë. Ndaj ajo kur kishte qenë në hekurudhë, nuk e kishte zënë me gojë fejesën e saj. Po i kish dëgjuar të gjithë ato që kishin ndodhur mbi trase. Dhe i kish ngulur mirë në mend. Dhe nisi të ëndërronte dhe ajo... ndryshe.

Pali i hodhi babait të Nikut kutinë e duhanit.

— Me të thanë të drejtën, ata të partisë duen me e çue në kurs për punëtorë.

I ati i Nikës u zbeh. Nuk ja merrte mendja që dhe Pali ta çonte vajzën në kurs. Se ishte burrëzakoni ai.

— Por ti, or Pal, don me e çue, a?

— Kur na thotë Partia, e pse jo.

I ati i Nikës u nxi. Sytë e hirtë ju turbulluan e ju skuqën. Po s'foli. U ngrit e dolli nga dhoma me çap të ngadalshëm. Kishte mbetur aty në çini dhe gota përgjysmë e rakisë dhe kutia e duhanit...

Nika nuk kishte thënë gjë për të fejuarën e tij. E pse të mos shkonte në kurs? Ai ishte minator. Që fëmijë ishte. M'rëpo vajza e Pal Gjok Palit bluante në mend ato që kishte mësuar në aksion. Dhe ishte matur shumë herë të bisedonte me të atin. Nika ishte tridhjetë vjeç. Djalë punëtor. Shtatë-lartë e buzagaz, po...

I kishte thënë asaj nja dy fjalë ai djali i Shtjefën Dodë Zefit kur ishte nisë ushtar:

— Sytë e tu do t'i marr me vete, Borë. E bashkë me ta do të kryej detyrën.

Ajo kishte ndjerë të rrahura të forta në gjoks. Se e njihte mirë djalin e Shtjefnit, që kur kishte qenë i vogël e shkonin bashkë me berra e deri sa një ditë ai i tha:

— Mos rri ma me mue, Borë. Ti je e fejueme.

— E pse?

— Se po hyj në gjak me njerëzit e të fejuemit tand mandej.

— Po ti je i vogël!

— Ani.

— Unë due me ndejë me ty. N'se ti s'don, atëhere shko. — Dhe Borës i ishin përlotur sytë e kthjellët, siç turbullohet ujët e Fanit moteve të vrënjtur. Pastaj ai ishte bërë minator dhe, kur shkoi ushtar, i tha:

— Pa të marrë s'të la, Borë.

Dhe u rrit me ëndrrën e tij Bora. U rrit si lule e bardhë në shkëmbin e ashpër, të rënë diku në një shpat mali. Po kjo ëndërr duhej ndërprerë.

«Patjetër duhet t'ja them babës» — mendoi ajo kur bëhej gati të shkonte në kurs,» — Duhet t'ja them». Në familjen e Palit jeta kishte rrjedhur e qetë. Atij i kishte mbetur hatri që krushku qe ngritur e kishte lënë në mes gotën e rakisë, po meqë Nika kishte shprehur dëshirën që Bora të shpinte në vend porosinë e Partisë, sikur ishte qetësuar. Atë natë kishte vajtur dhe Nika me të jatin të përcillimn Borën. Po ajo nuk kishte dalë fare. Se nuk

e thosh kanuni që të dilte nusja në sy të njerëzve të burrit e aq më pak në sy të tij. Po ajo s'pyeste për kanunin, ajo nuk donte vetë të dilte. Ishte shumë e shqetësuar. Miqtë pinin raki. Edhe Nika pinte. Ajo nuk e dinte në ishte a jo i rakisë Nika, po atë natë edhe ai pinte. Nika ishte djalë i mirë. Bora e kishte parë dhe herë të tjera. Dhe sepse i ishte mbushur mendja se ai do ta kuptonte. Ishte punëtor ai, minator... Po të atit i duhej thënë patjetër. Miqtë u ngritën. I përcollti vetë Pali. Ajo e vështronte atë nga dera e dhomës së zjarrit. Sa të vështrirë e kishte pasur të fliste hapur me të atin...

«Duhet t'ja them medoemos» — belbëzoi.

Pali hyri shend e verë dhe u habit kur ndeshi sytë e saj aty në dhomën e miqve.

— Ti, Borë, këtu?

— Po, babë. Ma deshte zemra me i ba dy fjalë bashkë.

E ç'ishin ato fjalë që donte të bënte me të e bija?

«Hej, o Pal! Ajo do të largohet për shumë kohë e do të bisedojë me ty ashtu si bijë e at. Se ajo e do shumë të atin».

— Po hajt, o Borë, bani ato dy fjalë me mue plakun, se veç për mirë ta kam ndie zanin.

— Kam ba sa kam mujtë, babë. Të kam dashtë e të kam nderue, — ja nisi Bora, — po këto dy fjalë që due t'i baj me ty para se të ndahena, druej se kan me ta vra zemrën.

Plaku ua dha një herë me dorë atyre mustaqeve të zverdhura, dhe zemra s'i ndolli të mirë.

— Druej se më korit, moj bijë, — tha me gjysmë zëri.

Ajo e pa se si ju prish fytyra të atit, si ju thellua

më tepër rrudha, e vetullat e dendura ranë mbi të.

— Për të koritë s'ma merr mendja, — tha ajo, — se bash fjalën e Partisë jam tue ndigjue e, nëse ka thanë ndoj fjalë Partia e kena dalë të koritun, atëhere edhe unë jam tue të koritë.

— Ku don me dalë, moj bijë?

— Babë, unë nuk e due Nikën!

Sikur ra tavani e i zuri brenda, sikur u hap dyshemeja, e i përpiu dheu, sikur u ngrit katundi e ja zhveshi lakuriq të bijën... Ashtu ju duk Palit.

«Jo, or Pal, s'të kanë ba veshët!» mendonte i ati ndërsa ajo ndjente zërin e tij:

«Sa ma ngrohin zemrën sytë e tu Borë! — i kishte thënë ai djali i Shtjefën Dodë Zefit. «Sa ma ndrisin jetën!»

Po Pali është njeri i fortë. S'ja merrte mendja se duhej të bëhej akoma më i fortë në plegëri e të kafshonte turpin.

— Po pse s'ma ke thanë ma parë, oj Borë, — murmuriti pa ditur ç'të thoshte.

— Kam dashë, babë, — tha Bora duke ndjerë dhembjen e të atit, — po edhe kam mendue se do ta prishësh vetë këtë fejesë.

— Vetë, unë me e kthye fjalën? — Pali dhe e kishte dëgjuar dhe s'e kishte dëgjuar të fliste kësh-tu të bijën.

— Po, se fjalën e Partisë e ke ruejtë si ujët e pakët në bjeshkën e naltë, e s'mbaj mend t'ja kesh ba dy.

— Unë t'ja baj dy fjalën Partisë? — tha ai i hutuar. — Po dy djem që i kjoftshin hallall, a nuk ja kam dhanë në luftë? Po vetë, oj Borë, a nuk i kam do plagë të hasmit në trup?

— Po, babë.

— E unë me ja ba dy fjalën Partisë?

— As më ka shkue ndoj herë ndër mend, babë.

— E atëherë?

— Kjo që po baj asht fjalë e saj.

— Oj Borë, po dhe fjala e dhanë dysh s'bahet.

Na kështu e kena pasë zakon dhe ti s'më ke thanë se nuk e don Nikën.

— Se kam qenë fëmijë.

— Po aj asht djalë i mirë, Borë.

— Unë nuk e due, babë...

Pali iku dhe u mbyll në dhomën e vet. E kish-te dashur shumë Borën. Dhe e donte akoma. Dhe fjalën Partisë ja kishte dëgjuar gjithmonë, se ashtu i kishin thënë edhe bijtë në frymën e fundit. E drejtë ishte fjala e saj. Po ama edhe këtë fejesë nuk donte ta prishte. I mërzitur dhe i inatosur siç ishte, të nesërmen nuk doli ta përcillte të bijën. Fundja, ai ishte i ati dhe duhej të vihej në vend vullneti i tij. Ajo duhej ta kuptonte se kjo që kërkonte të bënte, ja thyente zemrën, ja nxinte faqen. Dhe s'i mbetej veç t'i jepte mallkimin...

Po Bora e kuptonte dhembjen e të atit. Ajo e dinte se nuk ishte e para e as e fundit, që po bënte një gjë të tillë. Ndaj dhe e hapi derën e dhomës, ku ishte ngulur ai me cigaren në buzë.

— Babë, due me t'i thanë edhe do fjalë para se me u nisë.

Ai nuk e hapi gojën. Vetëm hodhi vështrimin e rreptë, nën vetullat e dendura, mbi fytyrën e bardhë e të çiltër të Borës. Dhe priti. Ashtu siç presin malet.

— Unë do t'ja them vetë Nikës, — tha ajo dhe doli.

Ura e Fanit është ngritur pak më lart se të bashkohen dy degët që formojnë Matin. Ajo urë ndan dy krahina. Nga njëra anë e saj ngrihen male të larta, majëzbardhura, dhe nga ato kishte zbritur Nika, ndërsa në anën tjetër zgjatet rruga e asfaltuar, qytetet, uzinat dhe që andej kishte ardhur Bora. Dhe qendronin të dy të heshtur mbi urën që ndante dy krahinat. Qendronin me dy mendime, që të dy të veshur me kominoshe.

— Borë, a e din pse kam ardhur?—Ja nisi Nika, jo aq për të marrë përgjegje, se sa për të kapur fillin e bisedës.

— Jo.

— Diç më thotë zemra, Borë. Sa të mbarosh kursin e martohemi. Lekë për me të marrë kam.

— Jo — tha Bora.

Kishte zbritur nga miniera Nika t'i thosh nja dy fjalë nuses. E vështroi me ata sytë e tij të kthjellët ngjyrë malesh. S'kishte biseduar ndonjëherë me Borën, dhe mendja nuk i vajti për të mirë kur dëgjoi atë fjalë. Dhe sepse heshti. Nuk deshi të fliste më. Po ajo donte të fliste. Ajo kishte vendosur të fliste.

— Nikë, — i tha, — na kanë fejuë prindët pa marrë pëlqimin tonë.

Ai mbërtheu vështrimin në vorbullat e lumit dhe nuk deshi të thyente heshtjen.

— Ti je minator, Nikë..

Atij ju duk sikur ishte një zë i panjohur, një zë që e kishte ëndërruar, po nuk e kish dëgjuar kurrë.

— Ti je punëtor, dhe punëtori e kupton më mirë se kushdo fjalën e Partisë. Dhe nuk e ban dy kurrë. Nikë duhet të kuptosh. . .

Ai e nxjerr nga ujët vështrimin dhe e hedh në fytyrën e qetë të së fejuarës.

— Vetëm që të çojmë në vend dëshirën e prindve, ne duhet të martohemi, — vazhdon Bora.

Ai më në fund vendos të flasë. Vështrimi i kthjellët ka marrë ngjyrën e ujit, që rrjedh në këmbët e urës.

— A don me marrë një vajzë që s'të do? — pyet ajo.

— Nuk më do, Borë?

Ajo rrudhi ballin. Dhe e vështroi thellë në y. Dy vështrime u ndeshën dhe morën ngjyrën e maleve.

— Zemra ime nuk më ka folë për ty, Nikë.

— Po pse, Borë?

Nika do që të mësojë gjithshka. Dhe e bën atë pyetje. Duket dhe lumi sikur pyet që aty poshtë, dhe malet që atje larg. E ç'i duhet të dijë më tepër atij, Nikës, minatorit? Dhe seç ndjen, seç vendos në mendjen e vet.

— Fundja nuk kam të drejtë, — belbëzon. Pastaj ngre shpatullat e rënda dhe e ngjit vështrimin nga malet. Dhe ikën nëpër urë duke lënë Borën aty në parmakë, me sytë hedhur në shpatullat e tij. Mos mendoj se nuk kishte të drejtë të martohej me një vajzë që nuk e donte?

«Megjithatë asht djalë i mirë» mendoj Bora, ndërsa trupi i tij i madh zvogëlohej në sfondin e hirtë të maleve. Po mendimet rendën me shpejtë-

sinë e tyre të habitshme në bjeshkë të largëta, të thella, të panjohura. Diku andej ishte i biri i Shtjefën Dodë Zefit ushtar...

* * *

Maqina ngjitej në asfaltin e zi me uturima të forta. Ndërsa Bora e mbështetur pas xhamit me vështrimin e hedhur përtej grykave të thella, nuk po shkëputej dot nga kujtimet e së kaluarës. Në maqinë kishin hipur edhe dy malësorët dhe tani pinin duhan, ndërsa shoferi vërtiste si pa qejf timonin.

— Nuk tërheq, dreqi, — tha ai duke futur në gojë një cigare të dredhur nga ato që i kishin dhënë malësorët. — Kam frikë se do të vonohemi. Malësorët këmbyen vështrime të shqetësuar. Po u kalonte dita në udhë. Dhe disa orë diell u kishte mbetur dhe atyre u duhej të ngjithnin male.

Bora vështronte grykat disi e mallëngjyer. Diku andej gjëndej fshati i saj me ato kullat e rralla. Atje ishin i ati, Pali, dhe shoqet. Sa e kishte marrë malli për të. Dhe për shoqet. Pastaj, Bora kishte hedhur sytë në një luginë të thellë. Andej ishte rritur Nika. I varfër si ajo, i pastër si ajo. E ç'do të kishte bërë Nika pas asaj që i ndodhi? Me siguri në kohëra të tjera do të hakmerrej. Pse hakmerreshin njerëzit në kohëra të tjera për gjëra të tilla?»

— Eh, sa mirë që Partia po i zhduk të gjitha këto, — psherëtiu ajo.

— Si the? — Ai me kutinë e këpucëve si duket e kishte dëgjuar, ose s'kishte dëgjuar gjë, po mundahej të hapte përsëri bisedë me punëtoreshin nga malësia. Seç e shtynte atë ta pyeste për shumë

gjëra. Se me sa po vinte re ai, Bora ishte një vajzë e thjeshtë, dhe i dukej e ditur dhe e zgjuar...

Maqina ktheu në rrugën e paasfaltuar që të shpinte në minierë. Ai me kutinë e këpucëve gjeti rast të pyeste.

— Po ti, ç'do në minierë?

Bora sikur u habit ca. Se nuk ishte kujtuar fare për takimin e afërt për të cilin kishte marrë tërë atë rrugë. Tani filloi ta mundonte një mendim që më parë as që e kishte shqetësuar. A e njihnte Nika atë djalin e Shtjefën Dodë Zefit? Se të dy ishin minatorë. Ky mendim e rrëmbeu të tërën, dhe ajo po mundohej t'i jepte udhë. Ndaj dhe takimi i afërt sikur trokiste fort në ndjenjat e saj. Që para se të nisej zemra i rrihte fort. Se ishte hera e parë që shkonte në minierë... Po ai me kutinë e këpucëve ja kishte kujtuar dhe tani priste përgjegjen.

— Do të takoj të fejuarin, — tha më në fund Bora dhe vuri buzën në gaz.

Malësori hapi sytë... Deshi të shtonte diçka, po pastaj u pendua. Mbase një «allahile» të zgjatur e të habitur. Dhe s'bënte tjetër veç tundte kokën, i mbytur në mendime...

II

Kishte një shok Nika. Një shok që e donte si vëllanë...

— Ja pra, Nikë, po të biem dhe një shok, — i kishte thënë Marku, sekretari i partisë. — Mësoji martelin, mësoji dhe të nderë minat. — Marku ishte larguar duke e lënë atë në këmbë. Nika kish-

te lënë martelin e kishte ngritur trupin e vet të fuqishëm.

— Si të quajnë?

— Marin, Marin Shtjefni. — Djaloshi që i kishin prurë i hodhi një vështrim të pastër. Sytë e padjallëzuar ja fituan menjëherë zemrën Nikës.

— Mua më quajnë Nikë, — tha ai, — ky asht marteli.

Sa kohë kishte që punonin bashkë, Nika nuk e mbante mend. Vetëm se ata u bënë shokë. Njëri hapte brimat, ndërsa tjetri vinte minat. Këtë punë bënin gjithnjë aty në galeri. Pastaj, shkonin te Froku e i tundnin banakun:

— Ore do marrësh birrë ti?!

— Po s'na kanë prue, or Nikë!

— Unë due birrë, — thoshte Marini.

— He pra, e sheh? Marini don birrë.

— Futi konjak.

— Ore birrë!

Nganjëherë aty në galeri, si kishin hapur vrimat dhe pregatisnin minat, bisedonin për vete. Ata e kishin shumë të vështirë të bisedonin për vete. Se nuk u vjen mirë minatorëve të flasin për vete.

— Unë due një vajzë, Nikë, — kishte thënë Marini.

— E don?

— Shumë.

— Asht mirë me dashtë, — kishte thanë Nika.

— Po ti?

— Eh!

— Si eh?

— Kam qenë i fejuem që i vogël.

Marini e kishte kuptuar. Si të gjitha dhe e fejuara e Nikës e kishte prishur këtë fejesë.

— Fundja kjo asht e drejtë, Nikë.

— Po, asht e drejtë. E pse me marrë një që as e njeh e as e don? Veç mue më ka ardhë keq se e kam dashtë. Nuk e di po më hyni në zemër... Se ishte e bardhë si bora, se ishte e thjeshtë si nana ime.

— Të vjen keq?

— Po, edhe më vjen keq. Ajo ishte e çiltër, e fjalët e saj pa drojë e pa dredhë më kanë ba me e nderue. Po t'i lamë këto. — Nika ngrihej më këmbë. — Veni minat. Due me i ndezë vetë.

Nuk zgjateshin shumë. Marini habitej me karakterin e fortë e të përmbajtur të shokut. Dhe e donte me gjithë zemër. Se kishte një shpirt të madh ai, Nika.

— Sikur ta dinte ajo vajza, sikur të të njihte, mbase kishte me të dashtë fort, Nikë.

Ai vinte buzën në gaz.

— Mbase dhe e ka ditë...

...Këto i vinin ndër mend atij minatorit të fuqishëm që mbante një dekoratë e që quhej Nikë, tek e vështronte Marinin që rruhej para pasqyrës së vogël e të rrjepur nga pas. Dhe që buzëqeshte... Se Marini, ishte fejuar me atë vajzën që i fliste në galeri. Nika ishte ngazëllyer dhe e uronte me gjithë zemër.

Marini u fshi shpejt e shpejt me peshqir, veshi këmishën, veshi pastaj dhe xhaketën dhe tha:

— U vonuem, Nikë!

— Shko përpara ti, unë po vij ma vonë.

— Jo, shkojmë bashkë.

— Njësoj asht. Unë po daj do llogari me Frokun. I ka ardhë birrë më duket. — Ai e pa Marinin të fluturonte nëpër shkallë e pastaj nëpër rru-

gën tërë gropa, dhe të zhdukej matanë kthesës, ku fillonte qyteti i minatorëve. Nika u rrua dhe vajti në klub. Mori gjashtë shishe me birrë, një tenxhere me meze dhe ca panine e pjata.

— Të m'i kthesh, Nikë, — tha Froku.

— Mos u ban merak.

Kishte filluar të binte muzgu. Një muzg i ftohtë. Po Nika ecte në rrugën me gropa. Sikur ta shihte ndonjë minator me siguri do të thoshte se Nika atë mbrëmje shkonte në takim. Se e kishte hequr fanellën e leshtë me grykë të zgjeruar, që mbante në galeri dhe kishte vënë gravatë. Nuk kishte vënë ndonjëherë gravatë dhe sa s'po mbytej. Megjithatë e duronte. Marini do të zemërohej po ta hiqte. Fundja Nika e kishte shok. Dhe për të duhej duruar dhe gravata...

Te kthesa kishte ndalur një shytë. Kishte zbritur dhe një vajzë në rrugën me gropa, ndërsa dy malësorë po i drejtoheshin Marinit, që nxitonte. Njëri nga ata që mbante një kuti këpucësh në dorë, diç e pyeti. Marini ja shpjegoi dhe deshi të shkëputej nga ai, po malësori si duket nuk u sqarua dhe e ndali përsëri. Nika e pa Marinin t'i tregonte prapë me dorë malësorit dhe të rendëte nga vajza. Nxitoi dhe ai çapin. Malësori me sa dukej prapë nuk ishte sqaruar dhe e ndali për të tretën herë Marinin, që këtë radhë e humbi durimin dhe bëri një gjest me dorë si t'i thosh: «Ti dëgjoke me hundë, or axhë». Pastaj malësorët vendosën të drejtoheshin në qytezën e minatorëve. Me sa dukej ish-in sqaruar plotësisht. Marini u takua me atë vajzën, që ishte e fejuara dhe që e prisnin të vinte. Nika i pa të qëndronin përballë njëri-tjetrit e të vështroheshin në sy. Ai ngadalësoi pak çapat. Po

të ecte dhe ca, ata do ta shikonin. Po ai qendroi. Se ku e kishte parë atë vajzë. Se me kë i ngjante. Ajo e vështronte Marinin me kokën të varur pak prapa. Se kush ishte ajo.

Shyta, që kishte lëshuar ata tre udhëtarë, i kaloi pranë duke nxjerrë tym të zi. Shoferi u var nga dritarja dhe tek e pa ashtu të ngulur si një copë mali mbi rrugë, ngaqë s'gjeti dot ndonjë të sharë aty për aty, tha:

— E, byrazer, me sa duket nuk është e fejuara jote.

Nika as që e dëgjoi, po pa pasur mendjen aty i hapi rrugë. Shyta rrëshqiti duke ndryshuar ngjyrën e tymit dhe duke lëshuar uturima të shkalluara.

Nika befas u kthye dhe ndoqi rrugën e shytës.

— Bora, — belbëzoi, — Bora asht! — Dhe nxitoi çapin nëpër gropat e rrugës.

«Ajo paskësh qenë e fejuemja e atij Marin Shtjefnit, djalit të Shtjefën Dodë Zefit. Dhe unë e kam dashë ma fort se vllaun. Ej Marin, Marin, ma paske pasë me të pabesë! — thoshte me mend Nika.

U ngjesh me të tjerët në klub, me sy të egërsuar dhe me një drithërimë të brendshme. Dhe me një zemërim në fytyrën e mvrenjtur.

— Hej, Frok! Një dopio raki!

* * *

Kishte rënë nata, dhe ai që prisnin nuk po dukej.

— Po kë presim kaq shumë? — pyeti Bora.

— Shokun tim.

— Po pse s'po vjen?

— Nuk e di. Mbase s'asht da mirë me Frokun.

— Dhe ne duhet me e pritë kaq shumë?

— Ai asht shoku im, Borë.

— Po atëherë shkojmë me e ndihmue për t'u da me Frokun.

— E rregullon vetë ai atë punë.

U bë natë fare, dhe ai që prisnim, si duket, kishte vendosur të mos vinte.

— Ikim, Borë, — tha Marini më në fund. — Mbase na pret në dhomë.

— S'më the si e quejnë shokun tand?

— Nikë.

Borës se si i erdhi. Me siguri nuk ishte ai, se Nika ishte dy male larg fshatit të tyre dhe çdo ta lidhte Marinin me të? Pastaj Marini e dinte se ai me të cilin e kishin fejuar atëhere, që kur ata shkonnin me berra, quhej Nikë dhe ishte minator.

Mirëpo vetëm në brigadën e tyre ishin tre Nikë dhe në të gjithë minierën bëheshin gjashtëmbëdhjetë. Po Bora nuk e dinte këtë. Nuk dinte dhe se njerëz si Nika e Marini nuk flasin shumë për punë të tilla. . .

Në dhomën e Nikës dhe të Marinit ishin dy krevatë, dy komodina, një raft, disa karrige, një tryezë e vogël dhe një fotografi e madhe në mes të saj. Dhe asnjeri brenda.

— Nuk qenka këtu, — tha Marini.

Bora i hodhi një vështrim dhomës së mobiluar thjesht dhe vuri re në këmbët e krevatit gjashtë shishe birra, një tenxhere të vogël, ca pjata dhe gjashtë panine mbi to.

— Si duket qenka rregullue me Frokun, — tha ajo.

Marini u gëzua që ishin nga dy për shoq dhe

i vuri shishet dhe tenxheren mbi tryezë, ndërsa Bora mori të tjerat.

— Unë po pregatis darkën, — tha ajo.

— Dó bash mirë. Nika duhet të jetë i uritur.

Marini mori diçka për të lexuar dhe u shtri në krevat, ndërsa Bora vuri gotat në tryezë. Gjer atë kohë e kishte shtyrë me duar, po nuk e kishte parë fotografinë me vërejtje. Në të ishin tre njerëz. Ai i mezit kishte një dekoratë. Ajo vështronte atë të mezit. Dhe për ca çaste nuk bëri asnjë lëvizje. Marini e ndjeu këtë dhe vështroi nga ajo.

— Ai i mezit asht Nika, — i erdhí në ndihmë ai. — Ka dalë kur e dekoruen si minator të dalluem.

— Bora kishte qëndruar e stepur para atij të mezit që e vështronte nga fotografia me një palë sy të kthjellët. Ajo e kishte njohur.

— Me siguri nuk është ai... tha Marini duke lënë të kuptohej, për të fejuarin e saj.

Bora u kthye nga djali i Shtjefnit, që kishte mbetur i habitur ashtu mbi krevat pa mundur të thoshte gjysmë fjale.

— Ky asht Nika — tha ajo.

Një valë mendimesh i kaplloi të dy. Një rrëmujë mendimesh. Pastaj Marini ndezi një cigare. Bora nuk e kishte parë ndonjëherë të pinte cigare. Do të jepte çdo gjë veç të dinte ç'mendonte ai atë çast.

— Borë, — tha ai i mallëngjyer, — nuk due me e humbë shokun.

III

Sa keq të vjen të flasësh me të gjithë e të mos flasësh me shokun. Ata të dy nuk flisnin. Ni-

ka zhbironte me martel shkëmbin e fortë, kurse Marini pregatiste minat. Llambat prej karbiti ndriçonin zbehtë errësirën e përjetshme, të nëntokës, duke përplasur hije stërmëdha në murin e zi të mineralit. Dhe mendjet e tyre bluanin, ashtu si maja e martelit shkëmbin. Nika ishte penduar që e kishte marrë me vete Marinin në galeri. Po ai pse i ishte ngjitur prapa? Për t'u justifikuar? Nikës i vinte t'ja përmblydhte turinjve. Fundja ç'i lidhte më ata?

Nika i mëshonte fort martelit. Marini e vinte re që ai e tepronte në të mëshuarit e martelit. Ai i kishte bërë gati minat dhe vështronte shpatullat e tij të forta, që dridheshin. Nika e ndjente vështrimin e tij. E ndjente në errësirë.

«E pse më vështron ai?» mendonte.

— Nikë, minat janë gati, — tha me gjysmë zëri Marini.

Ai foli apo ju duk ashtu Nikës? Ai s'kishte përse të fliste. Edhe prania e tij aty ishte e tepërt. Nika u ngrit më këmbë. Kishte hapur trembëdhjetë vrima. Marini duhej të vendoste në to trembëdhjetë mina. . . Nika ndjeu përsëri vështrimin e tij, atë vështrimin e çiltër që kishte ndjerë ditën kur ishte njohur me të.

I kishte marrë nusen ai Marin Shtjefni atij. Do të bënte mirë t'ja përmblydhte një herë turinjve. Po vështrimi i tij nuk e lëshonte.

E pse i kishte marrë nusen ai Nikës? Se mos ja kishte marrë nga shtëpia? Se mos e kishte pasur Borën ndonjëherë nuse ai? E kishin fejuar dhe aq.

«A do të marrësh një vajzë që s'të don, Nik?» i kishte thënë ajo.

Dhe ajo kishte marrë atë që i donte zemra.

Kishte bërë atë që duhej të bënte.

Nikës ju turbullua mendja. Mbrëmë kishte pirë raki te Froku.

«Atij Frokut do t'ja shemb dyqanin», — mendoi.

Vështrimi i Marinit e shqetësonte. E ndjente gjithnjë pas shpatullave.

— Futi minat — i tha ai Marinit.

I tha me gjithë mend ai apo ju duk sikur i tha. Mbase donte ta hiqte qafe vështrimin e tij, atë vështrimin e çiltër, prandaj i tha të fuste minat. Marini vendosi trembëdhjetë mina dhe trembëdhjetë fitilë. Nëpër këmbë i lloçoçitej uji. Dhe nga lart pikonte ujë. — Futu në furnel, — i tha Marini Nikës. — Tani do t'i ndez.

Nika seç ndjeu. Ditët e para që kishte ardhur në minierë Marini, ai shpesh kishte frikë se mos nuk ndizeshin fitilët. Dhe i ndizte vetë. Edhe këtë radhë ndjeu diçka të tillë.

— Do t'i ndez vetë, — i tha.

E pse i tha ashtu? Se mos i dhimsej më ai?! Me atë s'e lidhte më asgjë. Fundja ai e kishte mashtruar.

«Pse mendon kështu, Nikë?» tha me vete.

— Minat do t'i ndez unë, — tha Marini dhe ndezi shkrepën. — Futu në furnel.

Nika ishte ngulur aty pa vendosur ç'të bënte. Marini ngriti kokën dhe e vështroi thellë duke u munduar të kapte mendimet e shokut. Mbase ishte koha t'i fliste hapur.

— Nikë, pse s'erdhe mbramë? — i tha.

Nika i hodhi një vështrim mospërfillës, pastaj u kthye pas dhe eci drejt furnelit me mendimin se

kishte bërë gabim që s'ja kishte përmbledhur turinjve.

Nuk i kujtohej se sa ndenji në furnel duke pritur. Veç Marini duhej të kthehej e të futtej dhe ai atje. Si ndodhi kjo punë? Të mos duash t'i shohësh sytë tjetrit dhe të presësh me ankth të strehohet aty te ti! Se mos kishte faj Marini. Ku e dinte ai se cila ishte e fejuara e tij. Pastaj, se mos ishte e fejuara e tij ajo. Sa për të thënë se vetëm një herë kishte biseduar me të.

«Nikë, ti je punëtor dhe punëtori e kupton më mirë se kushdo fjalën e Partisë.» I kishte thënë atëhere Bora apo i ishte dukur atij se i kishte thënë ashtu. Ai e kishte kuptuar shumë mirë, prandaj ishte aq i qetë. Po Bora kishte pasur besim se ai do ta kuptonte. Fundja, fejesa të tilla ishin mbeturina kanunesh dhe ai ishte armik i betuar i kanunit.

«Marini duhej të kishte ardhë.» mendoi. Dhe e kuptoi se nuk ishte i qetë. Po kjo nuk kishte të bënte me kanunin? E ç'hynte kanuni këtu?

«Mbase duhen shkukur dhe këto rrënjë zakonesh», — tha me vete me mendjen andej nga duhej të vinte Marini, që po vonohej shumë. Vuri re se ishte mbushur gjithë djersë.

«Si asht kjo punë?» — tha me vete. Doli nga furneli dhe hodhi vështrimin atje ku punonte Marini. Dhe vuri re një garë të jashtëzakonshme. Djersët i vërshuan nëpër të gjithë trupin. Dymbëdhjetë dritëza të vogla rendnin nëpër errësirë me shpejtësi të madhe drejt dymbëdhjetë objektiveve të pa dukshëm në një largësi njëra nga tjetra. Ishin dymbëdhjetë fitilët e minave. Dritëza e anës së majtë lëvizte e para, dhe me sa kuptonte ai, po i afrohej minës...

«Fitolët», — mendoj Nika — Po pse vetëm dymbëdhjetë?»

Mos ja kishte mbathur Marini? Objektivi i të dymbëdhjetë fitilave ishin minat. Nuk mbetej shumë dhe ky objektivi do të arrihej nga dritëza e parë. Mbase ishte puna për disa sekonda.

— Marin! — bërtiti fort. E ndjeu që bërtiti fort. — Marin!

— Nuk ndizet e trembëdhjeta, Nikë!

— Lene shpejt, shpejt! — Nika kishte dalë nga furneli.

— Duhet ndezë!

— Largohu!

Ishin thirrje të forta sa armatura dridhej. Ishin hapa të rënda sa galeria tundej. Marini ndjeu në supe dy duar të fuqishme. Dy duar që e shkëputën nga fitilët dhe e tërhoqën me vehte. Ishin duart e Nikës, duart e shokut...

* * *

Nika ecte para, ndërsa Marini vinte pas tij nëpër errësirë, të dy të ndjekur nga copa gurësh. Ecnin me hapin e shpejtë e të sigurtë, duke lënë pas gjëmime minash. Nëpër këmbë u lloçoçitej ujë. Edhe nga tavani pikonte ujë, po ata ecnin. Njëri pas e tjetri para duke u munduar të gjenin daljen e galerisë. Dhe më pas tyre gjënimet e minave. Marini numëroi të gjashtë, të shtatë, të tetë... E trembëdhjeta nuk do të plaste. Ai nuk e kishte ndezur dot fitilin e së trembëdhjetës. U dëgjua dhe gjënimi i së nëntës... edhe i së dhjetës... Do të dëgjonin edhe dy të tjera. Po të trembëdhjetën nuk do ta dëgjonin...

— Pse e bëre këtë, Nikë!? — ju dha ta pyeste.

Nika nuk u përgjegj. Mbase nuk e dëgjoi. Ai vazhdoi të hidhte hapin e plogët e të sigurtë nëpër errësirë. Mbase ai mendonte për të. Për shokun...

«Se është shoku im» — mendonte ai. Se gjithshka duhet bërë për shokun...»

Mbase ishin sytë e Borës atje tej errësirës, sytë e kthjellët ngjyrë malesh. Sa të bukur janë malet në mot të kthjellët!..

Dhe sytë e Borës sikur kërkonin dikë. Mbase ashtu i dukej atij.

«Po Borë, duhet pyetë për shokun» — belbëzoi Nika duke u lëkundur nëpër errësirë. — «Se jeta e tij na asht e dashtun...»

Mbase ishte dalja e galerisë ajo drita e vogël që mezi dukej në errësirë. Po Nikës i pëlqente të mendonte se ishin sytë e Borës, që kërkonin shokun... .

ÇELËSI Nr. 14

Në kabinën e shytës hipën edhe dy gra me fëmijë. Ato zunë vend prapa, ndërsa unë u ula pranë shoferit. Gratë filluan të qetësonin fëmijët duke vështruar me drojtje nga ne. Shoferi lëshoi friksionin. Unë vura një cigare në gojë dhe i dhashë edhe atij një. Ai e mori në një mënyrë si të ishte diçka e zakonshme, aty në kabinën e tij. Pastaj, ndeza timen dhe ja zgjata atij. Ai e ndezi me vështrimin në rrugë.

— Kishe shumë që prisje? — më pyeti pastaj.

— Po, — i thashë, — nja dy orë në mes të vapës.

— Nuk kalojnë shumë maqina në këtë orë, — tha ai.

— Pse?

— Sepse ngrihen që me natë.

— Aha! — ja bëra dhe mendova se ai bënte rrugën e dytë.

Për një copë herë, ramë në heshtje. Njëpër dritaret dukeshin male shkëmbore dhe gryka të thella në këmbët e të cilave zvarritej një lumë i kaltër. Kush e di si bëheshin dimrit ato anë. Gra-

të, aty prapa, ishin rehatuar në sedile dhe filluan të linin mënjanë ndrojtjen. Pastaj, ja shtruan muhabetit.

— Shpëtuam mirë, — tha njëra, — aty te kthesa s'të merr njeri.

— S'të marrin kur s'kanë bileta, — tha tjetra, — se po patën edhe të marrin. Kanë frikën e kontrollit.

— Se mos ka kontroll këtej. Thuaj që qenka i mirë ky shoferi, pa...

Unë dëgjoja bisedën e atyre të dyjave, ndërsa vështrimin e kisha tretur në atë luginën me fund të sheshtë. Aty buzë lumit njerëzit korrnin.

— Kjo punë në mes të vapës të merr shpirtin, — më tha shoferi i mërzitur.

— Ç'të bësh, — i thashë. — Është kohë fushate tani.

Gratë zbritën te një urë. Shtëpitë i kishin në një fshat aty afër. Njëra nga ato e pyeti shoferin se sa i bënte haku.

— Nga pesë të reja, — tha thoferi.

— Tepër janë, — tha tjetra — po ç'të bësh, na more në pisk të vapës. — Ato nxuarën të hollat.

— Merri, të qoftë udha e mbarë!

Matanë urës, filloi një rrugë me gropa. Megjithatë, shoferi ja shtoi shpejtësinë maqinës, dhe unë fillova të hidhesha si në kolovajsë.

— I dëgjove ato? — tha pastaj ai. — Pande-hin se shoferët kanë interes të marrin pasagjerë në agjenci. Eh, mirë! Po preve biletë, neve s'na del gjë.

Unë nuk fola. Nxora dhe një cigare tjetër dhe e ndeza. Pastaj i zgjata dhe një shoferit. Aj e mori me atë mënyrën e vet të njohur.

— Cigare dreqi, — tha — ta bëjnë gojën helm.
E kanë prishur dorën.

— E prishin nganjëherë, — thashë unë duke më hipur befaz një dëshirë për ta kundërshtuar në çdo gjë. Po këto të Gjirokastrës preferohen.

— E mo, e — ja bëri ai — preferohen se janë të lira. — Ai e thithi fort, pastaj nxori tymin dhe pështyu nga dritarja. — Po ti ç'punë ke në minierë?

— Jam gazetar, — thashë unë.

— Aha! Reportazh me siguri.

— Po, — i thashë.

Ai e shtoi akoma shpejtësinë. Maqina trondi-tej dhe herë-herë hidhej përpjetë në gropat e rrugës.

— Kam frikë se mos nuk më ngarkojnë me kalkopirit, — sqaroi ai.

— Pse? — e pyeta unë.

— S'do të ketë.

— Bosh do të kthehesh? — Unë u shqetësova.

— Eh, jam vonuar, — psherëtiu ai dhe nguli sytë në rrugë.

Në minierë arritëm aty nga derka. Minatorët e kishin realizuar planin e kalkopiritit. Unë u takova me sekretarin e partisë dhe, së bashku me disa minatorë, hymë nëpër galeri. Mbarova punë dhe u ndava prej tyre.

— Me çfarë do të kthehesh? — më pyeti sekretari.

— Besoj me atë që erdha.

— Po pate nevojë, më thuaj, — tha prapë ai. Shoferi ishte bërë për të ardhur keq. E gjeta të nevrikosur me cigare të shuar në gojë.

— S'bëhet gjë, — më tha — e kanë tejkalluar planin. Ti sikur e ke mik sekretarin, thuaji pak.

— A mbaron punë?

— Ou, kur të duash.

Mirëpo sekretari ju drejtua minatorëve. Ata pranuan dhe e ngarkuan. Unë i falenderova dhe hyra në klub me sekretarin. Pimë nga një konjak dhe tek po dilnim, vura re shoferin, që po hynte në klub me nja dy vetë. Njëri sepse po i lutej.

— Mirë, — i tha shoferi, — thuaji të dalë te kthesa. Pastaj, duke m'u drejtuar mua, tha se do të nisej pasi të pinte një kafe...

Dielli na binte në fytyrë tërë rrugës. Të gjithë ishim mbushur me djersë. Edhe pasagjerët që kishin marrë te kthesa dhe që ishin ulur në sedilet e prapme. Njëri ishte minator, ndërsa tjetra gruaja e tij. Ata do të zbrisnin në një fshat diku pranë qytetit. Shoferi u tha se donte nga pesë të reja. Minatori e vështroi i habitur. Pastaj i dha dhjetë lekë. Mua se si më erdhi. Mbase minatori ishte ndonjë nga ata që i kishin ngarkuar vullnetarisht maqinën. Megjithatë shoferi, i kërkoi të holla. Kisha udhëtuar me shoferë në rrethana të tjera. I kisha parë në rrugët e Librazhdit, me sy të skuqur nga pagjumësija duke transportuar trupa ditë e natë për të dëmtuarit nga tërmeti. I kisha parë të rendin nëpër rrugët e ngrira, të varur për gjysmë nga dritarja me kokën lidhur me peshqir, ngaqë dëborat u kishte suvatuar xhamat dhe i pengonte për të parë rrugën. I kisha parë dhe në Dibër duke luftuar me akullin dhe dëborën. Mirëpo tani kisha të bëja me një shofer dosido, me një nga ata që u thërrasin shkurt: «shofer hesapi.» Dhe që u thonë pasagjerëve: «dil te kthesa» për të mos prerë biletë. Megjithatë, unë u mundova ta përmbaja veten. Shoferi dukej i qetë dhe i kënaqur. Ai e ngiste maqinën

ngadalë duke vështruar çdo kalimtar sikur të don-
te t'i thosh: «e, do vish?» Si nuk i dilte gjë, hidhte
vështrimin në asfalt dhe thithte me kënaqësi ciga-
ren. Megjithëse sikur zumë një farë miqësie, ai nuk
më fliste gjë për vete apo për punën. Madje as që
më pyeti se ç'bëra në minerë. Ajo tani kishte mbe-
tur prapa dhe ishte harruar. Bisedonim vetëm për
ndonjë gjë të rastit dhe tek po i afroreshin qytetit
L, ai e preu fare bisedën. U bë më i vëmendshëm
dhe dukej sikur më kishte harruar fare.

Në L. arritëm ndaj të ngrysur. Kishte filluar të
zbriste një mbrëmje e vakët. Maqina nuk kthehej
në Tiranë.

— Nuk mund të shkoj në Tiranë, — më tha,
— jam tranzit.

— Epo, ejvalla, shofer, — ja bëra unë dhe
zbrita.

— Nuk lahet rruga me një ejvalla, — tha sho-
feri, — luje, vëlla, luje!

Unë ndjeva të skuqesha sikur ai të më paguan-
te. Gjatë gjithë rrugës, nuk ja kisha vënë re mirë
fytirën shoferit, megjithëse as që më shkante me-
ndja se do të kërkonte ta paguaja. Duhej darovitur
shoferi apo duhej paguar? Mirëpo ai u kishte mar-
rrë të holla edhe atyre dy grave, edhe atij minato-
rit që mbase ishte nga ata që i ngarkuan vullnetar-
risht maqinën. Nuk i tregova as autorizimin, se u
binda që do të më thoshte se po ta kishte ditur,
s'do të më kishte marrë fare. Megjithatë, i duhej
dhënë ndonjë gjë që t'i vlente. T'i vlente përgjith-
shka, madje edhe për të ndrequr ndërgegjen. Të
holla kisha, po ai të hollat i fuste pa të drejtë në
xhepin e vet. Shoferi priste. Unë fillova të kërkoja

nëpër xhepa. Pastaj, në çantë. Shoferi vazhdon të priste.

— E gjeta, — thashë më në fund duke vendosur ç'ti jepja.

— Nuk dua ndonjë gjë të madhe, — tha shoferi, që pandehi se unë kisha gjetur portofolin, — aq sa të tjerët.

Po unë nxora një çelës. Një çelës të zakonshëm nr.14. E kisha blerë para nja dy ditësh, se çelësi. Nr. 14 hyn shumë në punë. Mirëpo, vendosa t'ja jepja këtij shoferi. Shoferi më priste me durim në sedilen e vet, me vështrimin e hedhur në rrugë.

— Merre! — i thashë duke ja lënë në dorë. — Do të të hyjë në punë.

Shoferi, që e mori padashur, më vështoi me habi dhe inat.

Pastaj tha se kishte për të më gjetur ndonjëherë tjetër në rrugë dhe e ktheu maqinën në të djathtë të qytetit ku ngriheshin oxhakët e një uzine..

* * *

Ata sapo kishin mbaruar mbledhjen. Dilnin nga salla dhe ndiznin cigaret; pastaj vazhdonin bisedën. Mbrëmja ishte e vakët, dhe shumë nga ata ishin mbushur me djersë. Unë isha vonuar. Megjithatë, prisja të takoja ndonjë nga ata të drejtorisë për të shkruar ndonjë gjë për mbledhjen. Ata ishin shoferë, xhenerikë, motoristë dhe flisnin me zë të lartë. Ndërsa unë qëndroja pak si mënjanë dhe gjer aty vinin copëra bisedash. Pranë meje qëndruan disa shoferë. Ata flisnin me zë të ulët, ndryshe nga të tjerët.

— Unë nuk e marr vesh atë njeri, — tha një shofer i trashë me një pulovër ngjyrë hiri hedhur supeve. — Ç'i duhet ta ngrejë në mbledhje, xhanëm. Pastaj, mirë që foli për vete, po pse na bëri thirrje dhe ne të tjerëve?

— Ai bëri shumë mirë, — tha një shofer i ri.

— E mo e! Donte të fitonte pikë.

— Ti flet si pasnesër, — u nxeh i riu. — E çfarë pikësh i duhen një shoferi. Ai bëri mirë. Unë e njoh Fuatin. Ai është njeri me sedër, po ja që kishte filluar ta shfrytëzonte makinën për interes të tij. Po, po ç'më sheh ashtu. Me makinë të shtetit u mblidhte para pasagjerëve.

— Mirë, mirë, — tha i trashi.

Ata bënë nja dy hapa dhe qendruan përsëri. Shoferi i ri vazhdoi të fliste.

— Njëherë kam udhëtuar me Fuatin. Më ishte prishur maquina në fushë-Arrëz, dhe u nisa me të për të gjetur pjesë këmbimi në parkun e Laçit. Kjo ka kohë. Fuati mori dy pasagjerë. Njëri nga ata i dha para. Unë e vura re se ai ja mori me një farë turpi. Mbase ishte herë e parë.

— Më vjen zor, — më tha pastaj — po kur marrin të tjerët...

— Kështu që i doli birra rrugës, — e ndërpreu i trashi. — E ç'e keqe e gjeti? Kurse tani ngrihet në mbledhje pa i thënë njeri dhe bën si ata kalamajtë: «kam bërë gabim, shokë...» Rri, o Fuat, për kokën tënde»

I riu e vështroi i zemëruar. Ndërsa ata të tjerët, që më shumë dëgjonin se flisnin e vështrojnë të riun me vëmendje.

— Megjithatë, Fuati bëri mirë, — tha pastaj njeri nga ata. — Mua m'u duk se ai ndjente për-

gjegjësi ndaj vetes. Vetëm më çudit një gjë. Kaq shpejt të bëjë një kthesë që të tjerët e kanë të vështirë.

— Fuati kishte kohë që kishte filluar të mos i merrte pasagjerët për interes, — tha i riu. — Që kur një punëtor ishte zemëruar, se, kur Fuati kishte ngelur një ditë në pikë të hallit dhe rrezikohej të kthehej bosh, punëtorët e kishin ngarkuar jashtë planit në kohën e pushimit. Megjithatë, kur një shok i tyre për një hall i kishte thënë ta merrte në makinë, Fuati i kishte kërkuar të holla. Prandaj, i ishte zemëruar ai punëtori. Dhe që atëhere ai më tha se ajo që kishte bërë ishte punë e poshtër. Pastaj se ç'i kishte ndodhur dhe diçka tjetër, po nuk ma sqaroi. U mbyll në vetëvete, dhe me sa kuptova kishte filluar ta vriste ndërgjegja.

— Mundet të jetë dhe kështu — tha njëri nga ata.

— Ashtu është, — tha i riu. — Unë e kisha vënë re të ndalej nëpër agjenci për t'u prerë biletë pasagjerëve. Kur nuk kishte agjenci ose bileta, ai nuk u merrte të holla...

Ata filluan të largoheshin duke biseduar. Tani unë nuk mund t'i dëgjoja më, megjithatë e kisha të qartë se ç'kish ndodhur me atë Fuatin. Mua sepse m'u kujtua ai shoferi që i kisha dhënë çelësin nr.14. Kishte kaluar kohë që atëhere, po sepse më dukej sikur... Mbase mund të ishte dhe ai, se në parkun e Tiranës punonte... Megjithatë, u futa brenda për të gjetur ndonjë nga të drejtorisë...

Kishin filluar shirat e vjeshtës. Ca ditë më parë, ishte kohë e butë, po pastaj moti qe vrejtur, dhe ja kishin nisur shirat. Atë natë, binte shi i imët që ta fuste të ftohtët nën lëkurë. Unë kisha dalë në mes të rrugës, disa qindra metra në të dalë të qytetit, dhe po prisja ndonjë maqinë. Më kishte lënë dhe treni i fundit. Ishte shumë vonë dhe pak mundësi kishte për t'u kthyer në Tiranë. Papritur, u afrua një maqinë dhe qendroi mu te këmbët e mia. Në dritat e saj zgjatet rruga e lagur. Një nga udhëtarët zbriti.

— Për Tiranë? — pyeta gjithë shpresë shoferin.

— Hip! — ja bëri ai.

U ngjeshja pas se kishte dhe dy të tjerë. Shoferi dukej i lodhur. Vështronte si me bezdi rrugën dhe thithte në heshtje cigaren. Në qytetin M. zbriti një nga udhëtarët, ai që ishte ulur me mua pas.

— Falemnderit, — i tha shoferit.

Shoferi i ktheu një: «s'ka gjë» të lodhur. Ne vazhduam rrugën. Ora po i afrohej nëntës.

— Për pak mbeta në rrugë, — foli sa për të hapur muhabet. Po asnjëri s'tha gjë. Ai tjetri do të zbriste në F.

— Sa të bën haku, — e pyeti shoferin.

— Asgjë.

— Jo, ore, pa gjë nuk të lej.

— Ik, ik, — i tha shoferi.

— Jo, mor, burazer. Ai filloi të mundohej t'i rrate një trelekësh në dorë, po shoferi nuk pranonte.

— Nuk e kam maqinë të babës, or mik, — i tha ai.

— Më ke bërë një nder të madh, o shofer.

— A nuk je dhe ti punëtor?

— Punëtor jam.

— Të dy jemi punëtorë, — tha shoferi. — E pse të mos i bëjmë nder njëri-tjetrit? E mira ishte të prisnit biletë, po meqë s'kishte agjenci, s'mund t'ju lija në mes të rrugës.

Punëtori u zhduk nëpër errësirë duke e uruar me gjithë zemër shoferin. Unë dola në vendin përpara. Nën reflektimin e dritave vështroja herë-herë profilin e tij të lodhur. Më kujtonte ata shoferë që i kisha hasur në rrugë të vështira, me sy të përgjumur, po me zemër të fortë, duke çarë rrugët e akullta për të shpënë me çdo kusht ngarkesën. Ata shoferët heronj më kujtonte ai.

Natën vonë, arritëm në Tiranë. Shiu kishte pushuar, dhe në asfaltin e lagur reflektoheshin mijëra drita...

— Shofer, — ja nisa unë, — më ke bërë një nder të madh, dhe nuk di si të ta shpërblej.

— Oh, s'ka gjë, — tha ai.

— Megjithatë unë dua të ta shpërblej, — thashë unë, — mua më vjen shumë keq të ndahem kështu nga ti. Për pak do të isha gdhire jashtë në mes të shiut.

— Mund të pimë ndonjë birrë, — tha ai.

Unë mora frymë i lehtësuar. Jo vetëm ngaqë në fund të fundit mund t'ja shpërbleja në një farë mënyre, po edhe se do të njihesha nga afër e mund të shkruaja ndonjë gjë për të. U futëm në një klub aty afër. Unë porosita birrë dhe meze.

— Për meze s'ka nevojë, — tha ai.

— Tani është punë për mua, — thashë unë.

Ai se si më vështronte. Fytyra e lodhur i dukej e qeshur. Mirëpo, ai se si më vështronte. Me siguri duhej të ishim parë gjëkund. U mundova të sillja ndërmend të gjithë kushërinjtë që mund të ishin shoferë. S'më dukej të ishte ndonjë nga ata. Ai ktheu gotën e birrës dhe pa e ulur tha papritur:

— Me të vërtetë nuk më njeh?

Mendova se me siguri më kishte ngatërruar me ndonjë tjetër.

— Nuk e di, — i thashë — si fytyrë e parë.

— Pranoje që nuk më njeh, — tha ai duke qeshur.

— Eh, mirë! Si të quajnë?

— Fuat — tha ai.

Mua më vajti mendja tek ai Fuati që flisnin shoferat.

— Kemi qenë një ditë në minierë bashkë — shtoi ai — . E mban mend? — dhe futi dorën në xhepin e pasëm të pantollonave dhe nxori një çelës.

M'u kujtua e gjitha. Dhe ishte po ai çelës nr. 14, që ja kisha dhënë unë, disa muaj më parë.

— Ma hodhe bukur, — tha ai duke vënë buzën në gaz. — Merre është yti!

— Tani kam gjetur një të ri, — i thashë.

— Jepja ndonjë tjetri. Ka akoma si unë.

Ti më dhe një çelës jo për vidhat e maqinës, se shoferi kujdeset shumë për të, po për ndërgjegjen. Nganjëherë harrojmë ta pastrojmë atë. Do bësh mirë t'ja japësh ndonjë tjetri.

Ai sado që vinte buzën në gaz kur fliste, dukej i tronditur.

— Domethënë ke vendosur? — e pyeta unë.

— Po, — tha ai. — Përpara ndërgjegjes sime dhe kolektivit.

Ai më la çelësin nr. 14 në dorë dhe vajti te maqina. Unë vështrova atë, pastaj çelësin. Ai ecte i qetë duke hedhur hapat e mëdha në asfaltin, që kishte filluar të thahej dhe dukej i sigurtë në veprimet e veta. Ndërsa çelësi ishte po ai, veç kishte marrë ca njolla vaji e grasoje.

RRUGË TË AKULLTA

Te kthesa në të hyrë të qytetit, u dukën dritat e një maqine. Shoferi, ose duhej të qe i krisur ose ishte mpirë nga të ftohtët. Maqina ishte një shtetë e re dhe ecte shumë shpejt mbi dëborën që kishte filluar të ngrinte. Shoferi e ndaloi para një shtëpie të vogël. Hapi derën e kabinës dhe u hodh poshtë. Ishte shtatmadh. Xhaketa prej lëkure me peliçe te qafa, dukej sikur do t'i çahet.

— Brrr! Sa ftohtë! — ja bëri.

Në shtëpinë e vogël, korridori ishte i ngrohtë, po asnjë dritë nuk qe ndezur. Derën që i duhej, e gjeti me hamendje. Soba kishte zjarr.

«Tani do të ketë rënë për të fjetur» — mendoi dhe ndezi dritën. Në dhomë ishin dy krevatë. Në njërin flinte një djalë i ri me fytyrë të ëmbël; të vinte keq ta zgjoje. Djaloshi kishte vënë buzën në gaz.

«Po sheh ëndërr sikur po martohet», — mendoi shoferi. E shkundi një herë fort.

— Ç'është — tha ai që flinte.

— Jam Rroku.

— A, erdhe Rrok! — Ai që flinte ktheu krahët.

- Ke mbërdhirë? Ngrohu, soba është e ndëzur.
- E shoh që është e ndëzur, po s'kemi kohë,
- tha Rroku. Ai që flinte nuk foli.
- Çohu, Avni!
- Ai që flinte u hodh përpjetë.
- Si është puna? — tha.
- Ata punojnë në tokë të ngrirë.
- Aha! — tha Avniu. — Si duket kanë qejf të plevitosen.
- Jo, nuk kanë tuba, — tha Rroku, — u janë thyer, dhe puna ka mbetur pezull.
- Ah! Paske ardhur nga Tirana! — thirri Avniu sikur t'i kishte dalë atë çast gjumi.
- Po, nga Tirana.
- Sa t'u bënë që je larguar, Rrok?
- Ore je në vete ti, apo jo?
- Jam që ç'ke me të. Ku i kam këpucët?
- Në këmbë i ke.
- E, pra, në këmbë, në këmbë? Ti m'i mba-
the?
- Jo, po flije ashtu.
- Sa është ora.
- Njëmbëdhjetë, — tha Rroku.
- Një orë paskam fjetur, ta hajë dreqi! — Rroku e kuptoi se ai kishte fjetur vetëm atë orë në dy ditë. Kishte punuar shumë ato ditë. Ishte puna e minatorëve. Të ftohtit e madh i kishte bërë të punonin ditë e natë. Avniu qe ngritur dhe po vinte tasin e rrojes në furnellë.
- Nuk do të shkojmë në dasmë — i tha Rroku.
- Mirë thua ti, — Avniu derdhi tasin. — Ora është njëmbëdhjetë.

— Unë kam ardhur me gjithë rimorkio. Tubat e rimorkios do t'i ngarkosh ti, — i tha Rroku.

— Aha, është fjala për në S. dhe K. Ta hajë dreqi, Rrok! Isha këputur për gjumë. Ti s'besoj të kesh fjetur fare.

— Jo, nuk kam fjetur.

— Ky zanati ynë është i poshtër. E takove Shpresën?

— Jo, nuk e takova, — tha Rroku — s'kemi kohë, Avni, kupton. Minatorët kanë mbetur në ditë të hallit.

— Megjithatë, mund ta takoje. Vajzën duhet ta ketë marrë malli.

— Edhe mua më ka marrë malli, — tha prerë Rroku.

Avniu doli jashtë të bënte gati maqinën. Kish-te filluar të binte prapë dëborë. Ai dukej i zbetë, i përgjumur, po shpatullat i kishte të forta.

— Punë dreqi, — ja bëri — a mund t'i ngjitesh S.-it tani?

Kishte dëgjuar për shoferë që çajnë dëborën me kokë lidhur me peshqir të nxjerrë jashtë dritares ngaqë xhamat ishin suvatuar nga dëborë. Dhe suferina u merrte frymën.

— Avni, maqinat janë gati, — tha Rroku, që kishte dalë pas tij. — Ti do të shkosh në S., ndërsa unë në K.

«Eh, mirë», — tha me vete Avniu. — «Ky Rroku! Zgjodhi për vete rrugën më të vështirë...»

II

Tek një kthesë rrugët u ndanë. Avniu u nis

nëpër rrugë të akullta, ndërsa Rroku në një rrugë që shkonte buzë greminave.

Në kabinë nuk bënte dhe aq ftohtë. Avniu nguli sytë në rrugën e ngrirë, që shkëlqente nga dritat. E pinte rrallë cigaren, po kur je vetëm në një rrugë të akullt, cigarja të bëhet një shok i mirë. Në paqetë atij i kishte mbetur vetëm një, megjithatë e ndezi dhe atë kur arriti në majat me dëborë. Aty ndanë rrugës, rrëzë pyllit, ai mbante mend një klub të vogël si të qe hapur për shoferët e vonuar apo për rojet e pyjeve, po ai ishte i mbyllur. Te dera e klubit vuri re nga larg një njeri të mbledhur kutulaç nga të ftohtët.

«Do të jetë ndonjë roje pyjesh», — mendoi. — «Mbase do të ketë cigare». — Njeriu që rrinte te dera e klubit, me të dëgjuar uturimën e maqinës u ngrit dhe i bëri shënjë të ndalej. Avniu e qëndroi maqinën dhe u hodh në rrugë. Po mbeti i ngrirë. . .

Në pyje nuk është si atje poshtë në qytet ku nata e ftohtë ndrit nën llambat e neonit. Në pyje, ku dëborë arrin një metër trashësi, shkrepëtinjë sy ujqërish, që zhbirojnë errësirën e ftohtë. Në drejtim të klubit afroheshin ulurima ujqërish. Avniu kishte pasur të bënte dhe herë të tjera me ujqër, po në të tjera rrethana. Ndjeu t'i rrokulliseshin nëpër trup pikëla të ftohta djerse. Ai gjithmonë kishte pasur frikë nga këto bisha të guximshme. Njëherë kishte parë një bari plak të ndeshëj me ujkun, që i kishte çarë tri dhi dhe i kishte gjakosur qenin. Kishte parë një luftë të dëshpëruar, që bënte një njeri i fortë, po i mplakur, me bishën. Vetëm zemra hakmarrëse e plakut mund ta pranonte atë luftë.

«Mirë unë që s'i dëgjova, po ky?» — mendoi Avniu dhe ju afrua njeriut që ishte mbështjellë me një napë të zezë dhe po i dilte përpara. — Hej, xhaxho! — i thirri — në qoftë se ke armë, nxirre!

Njeriut i ra napa nga supet. Nuk ishte xhaxho siç i thirri shoferi. As roje pyjesh nuk qe... Dy hapa larg tij, nga rrobat e zeza kishte dalë një fytyrë e qetë, e ëmbël po e lodhur vajze...

— Ç'bën këtu, nuk ke frikë? — i thirri Avniu. Ulurima nuk ndiheshin më, po ai dëgjoi skërmitjen e dhëmbëve. Dhe ai e dinte ç'do të thoshte kjo. Për fat të mirë kishte harruar dritat e ndezura.

— Eja shpejt, — i thirri.

Vajza nxitoi të ngjitej në kabinën e shtytës.

* * *

Rroku kishte filluar t'u ngjitej grykave të thella ku fryjnë erëra të forta, që e ngjishnin dëborën pas xhamave të maqinës. Ai nxori fotografinë e vajzës dhe e vuri aty në pasqyrën e vogël. Rroku e donte shumë vajzën. Verës e merrte edhe maleve. Në fotografi ajo kishte dalë fytyrëqeshur dhe me leshrat e verdha të lëshuara supeve të vogla. Buzët i kishin mbetur hapur sikur do të shqiptonin «babi». Dhe ai e kishte ndjerë, në rrugët që çajnë pyjet, zërin e saj dhe i qe përgjigjur padashur.

Rroku i dha një të puthur me buzë. Ju duk sikur ajo ja ktheu të puthurën, dhe befasi maqina u trondit në rrugën e ngrirë dhe me gropa.

«Ta hajë dreqi!» — shau me vete.

Kabina kishte kaloriferë dhe bënte ngrohtë. Po jashtë, moti ulërinte me furtuna dëbore. Foto-

grafia dridhej nga lëkundjet e maqinës. Gropat e e rrugës e bënin të lëvizte me vështirësi, dhe Rrokut i vinte të hante veten me dhëmbë, ngaqë i dukej sikur vajza i thoshte ta ngiste më me kujdes. Ai ishte mësuar të ecte shpejt...

«Mua më mori malli, babi», — ju duk sikur i tha fotografia.

«Edhe mua» — tha ai me mend.

«Ti s'ke ardhur fare».

«Po s'kam ardhur... ç'të bësh... puna».

«Ti punon shumë, babi. Edhe xhaxhi Avniu punon shumë».

«Po, punon shumë».

«Po pse kaq shumë?»

«Që kur të rritesh ti, t'i kesh të gjitha».

Maqina uturinte midis greminave. Jo nga të gjithë rrihen ato rrugë netëve të tilla. Po atje në K., disa qindra minatorë kishin pezulluar punën. Duhej patjetër të arrinin aty tubat e sondave. Rroku e kishte bërë shpeshherë këtë rrugë, po kaq e ngrirë s'kishte qenë kurrë. Stuhia nuk kishte rreshur, dhe dëbora vazhdonte të binte. Maqina po merrte kthesën në zverk të greminës. Rroku mundohet të mos e shqiste vemendjen nga rruga dhe frenat. I vinte gjumë. Po bëheshin pothuaj dy ditë që s'kishte vënë gjumë në sy, po ai ishte i fortë dhe mund të mposhte gjumin. Ai duhet ta mposhte gjumin. Te këmbët e sediles tjetër kishte një shishe përgjysmë me konjak të mirë Korçe. E kishte blerë kastile për këtë udhëtim, atje në Tiranë. Gjysmën ja kishte dhënë Avniut. Në temperaturën tetëmbëdhjetë gradë nën zero nuk udhëtohet pa ndonjë gjë të nxehtë. E mori shishen me kujdes të madh.

«S'mund t'i bëjnë ballë kaloriferët këtij të ftohti» — tha me vete dhe, pa i shqitur sytë nga rruga, ktheu shishen.

«Unë s'dua, babi» — ju duk sikur tha fotografia.

Rroku qeshi. Tek po merrte kthesën, mundej të dallonte greminën. Po ajo s'dukej fare. Befas ai ndjeu një tronditje të lehtë. Pastaj, maqina mori menjëherë majtas. Rroku ndjeu se po ecte mbrapsht. I dha gaz, frenoi, u mundua të siguron-te frenat e dorës. Krahu i majtë i maqinës u anua menjëherë. Shoferi hapi derën dhe u hodh poshtë.

«Babi!»

Ai qendroi i ngrirë, sikur fshikullimat e tufanit ta kishin ngurosur aty ndanë rrugës, sipër greminës. Kjo ishte punë sekondash. Kërcuri ku kishin penguar rrotat e prapme krisi lehtas...

«Po maqina?...»

III

Avniu këputi një të sharë dhe e përplasi akoma më fort derën. Nga rrëmbimi kishte dërmuar këmbën e ngrirë dhe s'i mbetej veç të shante.

— Rri në sedilen tjetër, — i tha me fytyrë të shtrembëruar nga dhembja vajzës, që ishte ngjitur me vështirësi në kabinë dhe s'po dinte ku dhe si të shkonte.

— Si?

— Thashë të rrish në anën tjetër. — Vajza kaloi në anën tjetër, me sy të unjur përdhe. Ajo dridhej e tëra nga të ftohtët dhe nga shqetësimi.

«Sidoqoftë është femër» — mendoi Avniu

duke vështruar vajzën. Nxori shishen me konjak që i kishte dhënë Rroku dhe i tha të pinte pak.

— Të falemnderës, po nuk më pihet, — tha vajza me zë kumbues. Atij ju duk sikur ajo i fliste nga një sallë e madhe me mure mermeri, dhe mbeti një çast pa ditur si të sillej me të. Pastaj, u mundua t'i mbushte mendjen:

— Pi pak nga kjo, ndryshe kap sanatoriumin.

— Si?

— Pi pra, nuk është zeher. — Vajza mori shishen e konjakut.

— Pi! — tha Avniu. Vajza piu.

— Qeka e xehtë, — tha. Pastaj piu prapë. Lot i shkonin nga sytë, po vështrimi i djaloshit i thoshte të pinte. Vajza ndjeu një të nxehtë të madh. Nuk piu më dhe i ktheu shishen. Avniu piu nja dy gllënjka. Vajza ja nguli sytë për një çast, pastaj e rrëshqiti vështrimin në çizmet e tija.

— Të është çarë çizmja, — tha ajo.

— Eh, lëre dreqin! — Ai e preku me dorë dhe ndjeu t'i lagej.

— Gjak! — tha vajza — ta heq çizmen?

— Do mundohem ta heq vetë. — Ai u përpoq të hiqte çizmen, po ndjeu dhembjen. Vajza e pa se si e rrudhi fytyrën ai dhe i tha se do t'ja hiqte pa e lënduar. Dhe nuk e lëndoi. Avniu pa çizmen e çarë.

— Çizmet e Rrokut, — tha.

— Të kujt?

— M'i dhuroi shoku im për ditlindje. Pardje mbusha njëzet e pesë vjeç. — Vajza kishte hequr dhe pecen, që ishte bërë me gjak. Në këmbën e tij, ajo vuri re një të çarë.

— S'është ndonjë gjë e madhe, — tha Avniu.

— Je vrrarë shumë, — tha vajza. — Do të enjtet.

— Shih se aty prapa ka një teneqe me benzinë. Vajza mori poshtë sediles një bidon të vogël me benzinë dhe ja dha. Avniu lau këmbën. Vajza u mundua të griste një copë nape të zezë. Ai i tha të mos e griste, po ajo kishte çjerrë një rrip të gjatë dhe ja lidhi. Napa e zezë s'hynte më në punë tani. Ajo mbeti me fustan të bardhë si nuse dhe kjo e bëri djaloshin të kujtohej se ishte në rrugë dhe se njeriun që po kujdesej për të, ja kishite rrëmbyer natës së ftohtë dhe bishave. Ajo kishite ftohtë. Dhe Avniu hoqi xhaketën me peliçe te qafa e ja dha.

— Vishe! Ti ke shumë ftohtë.

— Po ti?

— Unë nuk mbërdhah. Ai i dha prapë konjak dhe me një këmbë mbathur e me një z bathur i dha maqinës. Sytë i nguli përsëri në rrugën e akullt duke harruar në kishte njeri në maqinë apo jo. Tani mendonte vetëm për minatorët, që e prisnin me padurim në S. Dhe për Rrokun...

* * *

Rruga dredhonte nëpër pyje të ngarkura me dëborë dhe shoferi sado që ishte gjysmë i zhveshur, kishte filluar të djersinte. Padashur hodhi sytë në sedilen tjetër. Aty rrinte ajo vajza e re, me vështrimin e ngulur përtej xhamave. Një vështrim i ndrojtur dhe i shqetësuar.

— Si të quajnë? — e pyeti.

— Marta, — tha ajo.

Avniu ishte kujtuar se e kishte gjetur në mes të rrugës dhe i erdhi çudi se përse kishte dalë në mes të rrugës në një natë të tillë. Deshi ta pyeste, mirëpo ajo kishte shqiptuar vetëm emrin dhe vështronte e shqetësuar rrugën. Herë-herë ngashërehej. Ai vështronte me bisht të syrit profilin e saj.

— Për ku ishe nisur? — ja filloi ai.

Vajza psherëtiu.

— Desha të shkoja në komitet të partisë.

— Tani natën?

— Jo, nesër, po më zuni nata aty.

— Nuk kishe frikë nga ujçërit? — e pyeti prapë ai duke kujtuar fshatarët, që e kalojnë nganjëherë natën jashtë. Vajza u drodh sikur ta kishte përshkuar një rrymë e ftohtë ajri. Pastaj, e vështroi me sy të përlotur.

— Po, kisha. Kisha shumë, — i tha.

Avniu kuptoi që diçka kishte ndodhur me të. Diçka e madhe për të cilën ishte vështirë të flisje. Vajza nuk vazhdoi më dhe e hodhi përsëri vështrimin në rrugë. Shoferin filloi ta digjte kuresh-tja, mirëpo nuk vendoste ta pyeste përsëri. Mbërtheu dhe ai vështrimin në rrugë dhe priti që t'ja niste përsëri bisedës. Po ajo ishte zhytur në botën e vet të fshehtë. Befas, të dy kthyen kokën dhe vështruan padashur njëri-tjetrin.

— A ke motër? — e pyeti ajo.

— Po, — u përgjegj ai. — Është fejuar me një student. Edhe ajo është studente.

— Sa kohë ka që e ke fejuar?

— Se mos i fejova unë. U fejuan vetë, — tha ai.

— Vetë?

— Po, vetë. E donin njëri-tjetrin dhe...

Ajo nguli përsëri vështrimin në rrugë. Në dritat e maqinës rruga dukej si diçka e bardhë, e stërzgjatur, që humbiste diku përtej errësirës.

Në fytyrë ju ndeh një buzëqeshje, që ngriu ca kohë gjersa ajo tha si me vete:

— Sa mirë! — Dhe përsëri buzëqeshja i ngriu në fytyrë. Avniu pati kohë t'i hidhte një vështrim, pastaj sytë i ktheu përsëri në rrugën e bardhë. Mbase e kishin fejuar që të vogël, ashtu sipas zakoneve të tyre dhe tani ëndërronte. Kush e di ç'mund të ëndërronte.

— Mue më fejuen që tetë vjeçe, — bëlbëzoi ajo.

— Ju kështu e keni zakon të fejoheni, — ja ushqeu fjalën Avniu.

— E kanë zakon të na fejojnë, thuej, — tha ajo.

— Merre si ta marrësh.

— Jo, nuk duhet marrë si ta marrësh. Kur je tetë vjeçe as që di se ç'bajnë me ty. Sot i mësova të gjitha. Siç e sheh jam veshë nuse. — Avniut ju kujtua se atë ditë ishte e shtunë.

— Mue deshën me më çue te burri, — ja nisi ajo. — Unë ua pata thanë prej kohe, se atje s'shkoj.

«Do të shkosh» — më tha vëllai.

«Dekun, — i thashë — se gjallë s'shkoj». — Unë ja kisha thanë që kur mësova nga këto gjana. Po ai s'm'i vinte re. Parmbramë më veshën nuse. Unë bërtita, qava, po më sa ligshtohet muri i kullës prej lotëve të vajzës, aq u ligështue dhe zemra e vëllait. «Gjallë a dekun do të shkosh» — më tha. Unë s'foli. Ai doli. Si prita të largohej, dola, ashtu si isha e veshun, tinëz njerëzve, që po këndonin matanë. S'mundta të mirrja veç kët rrobë të zezë për me mbulue të bardhat. E dija se po të

vinte atë çast vëllai, s'kisha për t'u nda mirë me të. Po robi asht si shqipja, ma mirë dekë se mbyllë për trup e lidhë për zemër. Dhe ika. Ika për me marrë një rrugë pa krye e pa fund. Një rrugë të ftohtë të mbushur me llahtar. Se si kam mbritë atje ku më gjete ti, as vetë s'e di.

Maqina kishte dalë në një vend të zveshur dhe nëpërmjet xhamave, që kishin zënë një cipë avulli, ata mezi shihnin dëborën e madhe që kish mbuluar shkëmbinjtë.

— Mbase vëllai më ndjek kamba-kambës — e mbylli Marta.

— Pse nuk shkove te shokët e partisë në fshat, po more gjithë këtë rrugë, — e mbylli Avniu.

— Im vëlla asht komunist, — tha ajo dhe pshe-rëtiu. Avniu u habit. Pastaj lëshoi një të sharë:

— Çfarë dreq komunisti qenka ai! Ai nuk është komunist i vërtetë.

— Vëllai im asht komunist i vërtetë, — përsëriti Marta.

— E pse mendon kështu?

— Ai ishte i pari që ngriti kooperativën. I pari që bashkoi me tokat e kooperativës tredynymshin e vet. Vëllai im ishte ai që në kuvend të burrave u ngrit e tha se bagëtitë e tepërta po ja falte kooperativës. Nuk e njeh ti, prandaj truen. Ai asht njeri i fortë. I pari u ngrit mes borës, kur të gjithë malësorët ngroheshin në votra, e tha se dimrit duhet t'i rrëmbejmë malit toka buke. Dhe në krye me kazmë në dorë shkoi me hapë toka të reja.

«Punë dreqi» — mendoi Avniu. «Ç'e shtyn një njeri të tillë të bëhet bishë për motrën. Kaq të rrepta janë ligjet e kanunit? Po pse i pranon ve-

primet e të vëllait? Pse i pranon, ta hajë dreqi! Nuk e di ajo se disa kilometra më tutje njerëzit nuk i pranojnë kanunet?»

Maqina tani po zbriste ngadalë nëpër rrugën e ngrirë. Avniu mundohej t'i bënte bisht akullit, po nuk ja arrinte gjithmonë, dhe herë herë maqina shkiste e tronditej. Atëhere, ai këpuste ndonjë të sharë duke harruar se aty në kabinë kishte dhe një vajzë. Si mori kthesën, vështroi përsëri vajzën.

«E nga ta dijë ajo?» — mendoi. Ajo është ngritur e ka ecur nëpër rrugën e akullt pa e kuptuar se ç'po bën, pa e ditur se po shkel nëpër kanune. Mbase ajo akoma nuk shikon ndonjë gjë të keqe në ligjet e lashta të maleve...» Ai u kthye nga ajo.

— Nuk të kuptoj dot, Marta, — i tha — Ç'ke menduar të bësh?

— Nuk e di. Po në shtëpi nuk kthehem ma.

— Po qe se do, eja me mua... Unë do të çoj në një vend ku do të bindesh se vëllai yt nuk është pjekur si komunist.

— Po ti a je komunist?

— Jo, akoma,

— Komunistët janë njerëz të mirë, — tha ajo.

— Ata që nuk janë si vëllai yt. Po ti pse nuk e deshe burrin? — e pyeti Avniu dhe e vështroi vajzën në sy. Ajo ishte shumë e mirë. Avniu padashur se ç'ndjeu përbrenda. Ju duk sikur e njihje prej kohësh vajzën. — Mos deshe ndonjë tjetër? — Avniu u skuq në fytyrë. Martës nuk i shpëtoi kjo. Edhe ajo u bë lulëkuqe.

— Jo, nuk kam dashun ndonjëherë, — i tha ajo pa të keq. — Po s'mund të lidhem me një njeri që s'e njoh e s'di kush asht. A asht e drejtë kjo?

— Po a e mendove ç'do të bëje? — pyeti prapë Avniu.

— Jo. Unë vetëm mora dekën në sy.

* * *

Avniut i vinte keq për ato që i kishin ndodhur asaj, po dhe i erdhi mirë që ajo nuk donte të qëndronte pasive ndaj atyre që bëheshin në kurriz të saj. Tek vërtiste atë timonin e madh, i dukej se vajza të tilla janë njësoj trimëresha si ata, njësoj të forta si ata shoferët që çajnë rrugë të akullta, rrugë malesh e kanunesh. Dhe diç ndjeu për të. Dhe deshi ta ndihmonte të hynte në një jetë të re, që ta kuptonte thellë atë që kishte bërë dhe të gjykonte pa ndroje mbi të vëllanë. Ata do ta ndihmonin. Ai, Rroku, shokët...

— Marta, ti nuk ke frikë nga unë? — tha ai.

— Jo, ti më ke shpëtue jetën. E unë ta kam borxh atë.

— Jetën? Si unë do të kishte vepruar kushdo që do të kishte qenë në vendin tim. Po unë nuk të pyeta për këtë.

— E për çfarë atëhere?

— Unë desha të them se a ke qejf të punosh në uzinë?

— Në uzinë? E ç'mund të baj unë atje? — Kishte dëgjuar për uzinat ku derdhet, duke përhapur mijëra shkëndija, metali i shkrirë. Atje punojnë qindra vajza. Po ato s'ishin malësore. Sa mirë do qe në uzinë! Po... a do ta pranonin ata? Ashtu siç ishte e paditur? Mjerë kush do të guxonte ta fyente krenarinë e saj, ajo s'donte të bëhej lojë e të tjerëve. Malësorja nuk e dinte se

në uzinën e re, njerëzit e rinj kishin ardhur të pamësuar, ashtu si ajo. Dhe Avniut s'i vajti në mend se vajza ishte prekur.

— Ti do të vish me mua, — tha Avniu. — Po të duash do të banosh në një hyrje me shokun tim. Ai ka gruan dhe një vajzë të vogël. Ata janë njerëz të mirë dhe do të të mbajnë gjithmonë pranë.

— Rroku?

— Po, Rroku. Ai është shoku im.

— Ç'janë këto drita? — tha Marta, që dukej sikur s'i ndiqte fare fjalët e shoferit.

— Arritëm në minierë, — tha Avniu. — Rroku do të të rregullojë të punosh në uzinë.

— Po ku asht Rroku tani?

— Në një rrugë tjetër, — Avniu psherëtiu. — Në një rrugë të akullt. Pastaj i tha se s'do të donte gjë tjetër veç të merrte vesh në i kishte çuar Rroku tubat apo jo. Në K. minatorët i prisnin me padurim.

Vajza e kishte harruar shoferin, dhe sytë i kishte ngulur në dritat e rregullta të qytezës së minatorëve dhe në hijet që lëviznin me të shpejtë. Ju duk sikur po hynte në një borë të re, të cilën me siguri do ta kuptonte, sepse e kishte ëndërruar... Madje ajo kishte filluar ta kuptonte, që kur filloi të bisedojë me shoferin, me atë djalë të mirë, që e kishte marrë në mes të rrugës dhe po kujdesej aq shumë për të. Ndjeu se do t'i vinte keq që do të ndahej nga ai, megjithatë asaj nuk i pritej sa të zbriste midis njerëzve ku me siguri do ta ndjente veten ngrohtë dhe të rrethuar me dashuri.

— A do të vish, Marta? — dëgjoji si nga diku larg shoferin. Minatorët rrethuan maqinën.

— Tubat, tubat erdhën — se kush thirri.
Po fillonte dhe një ditë e re...

IV

Rroku rrëmbeu një kavo të fortë e hodhi nyjen e parë në kanxhën e parakolpit dhe me një shpejtësi të madhe u rrotullua pas një rrapi të lashtë ndanë udhës. Pastaj, kavon e lidhi fort me tërë fuqinë e krahëve të tij. Maqina megjithatë lëvizte mbrapsht. Lëvizte ngadalë, po sidoqoftë lëvizte. Rroku sakaq kishte marrë një çelës të madh në duar, të cilën e futi në nyjen e metaltë të kavos. Tani s'kishte më rrezik të zgjidhej, po a do ta mbante? Kërcuri që kishte penguar rrotat e prapme të krahut të majtë, qe thyer dhe maqina rrëshqiti.

«Maqina duhet shpëtuar patjetër» — tha Rroku me vete. «Mundohu të lehtësosh patjetër peshën e saj, ndryshe o kavua o rrapi...»

Atij i shkuan djersë të ftohta. Pati frikë se motori nuk do të ndizej, po u ndez. Nuk ishte ftohur akoma. I dha gaz maqinës. Po nën dritat e saj pa të tendosej shumë kavua, e rrapi të tundej e t'i shkundej dëbora nga krahët e tij të trashë.

— Mbrapsht, mbrapsht, ta hajë dreqi! — shfryu Rroku, — vetëm rrugën e greminës di? Ai i dha gaz prapë. Prapë kavua u tendos, dhe u shkund rrapi, po maqina zbriti një pëllëmbë më poshtë. Padashur hodhi sytë te fotografia e së bijës. Ajo po e vështronte me buzë të hapura, me ata sytë e qeshur e femënorë. Vajza shihte fytyrën e të atit

të mbuluar me djersë në atë temperaturë tetëmbëdhjetë nën zero. . .

Kishin kaluar disa orë luftë, kur padashur ktheu sytë nga K. I hodhi një vështrim të lodhur errësirës nga duhej të gjendej K. Diku mes malesh gjendej. Befas, pa. . . Aty midis grykave, tutje thellë, në errësirë dy drita, dy sy të vegjël që zhbironin natën e zezë. . . Pastaj, u zhdukën, pastaj dolën dy të tjera. Edhe ato u zhdukën.

Mos i kishin bërë sytë Rroku?

«Ç'pe ashtu, babi?»

«Drita pashë». Kush mund të kishte qenë në K. dhe të ishte nisur n'atë orë? Rroku i pa dritat prapë, po shpresa e ngjallur në çast ju tret diku.

«Po vijnë shokët, babi?»

«Tani s'të ndihmon njeri. Edhe sikur të duan, nuk do të mundin».

«Pse?»

«Sepse rruga është e ngrirë, dhe ata mund ta pësojnë për vetë!»

Po kalonte dhe nata e dytë pa gjumë. Motori i ndezur dukej sikur s'kishte më fuqi të merrte vrull. Ndërsa dritat sa vinin bëheshin më të mëdha, më të forta.

«Vetëm një njeri mund të ecë nëpër këtë rrugë», — mendoj Rroku. «Po ata qenkan dy. Zakonisht në rrugë të tilla nisen dy vetë, po ai shkon dhe i vetëm. Dhe atë çast i doli përpara fytyra e hequr e Besimit. «Shokët atë e kanë quajtur shofer të dëborës dhe të akujve.» Rroku nuk besonte se mund ta ndihmonin. «Ai tjetri mund të jetë Ahmeti. Si duket kërkon të mësojë se si mund të çash në rrugët e akullta.» Rroku psherëtiu. . .

— Tani nisu, Rrok, dhe... shkelja pak, —
tha Besimi.

— Po ti?

— Unë nuk jam ngarkuar me tuba.

Maqina e Rrokut ishte kthyer në drejtim të kundërt me dy maqinat e tjera. Shoferët dhe një i katërt, që kishte zbritur nga maqina e Ahmetit ndëzën nga një cigare. Rroku gjer atëhere nuk e kishte vënë re mirë atë të katërtin që ishte një malësor i gjatë, nja tridhjetë e tetë vjeç, po kur i mori cigaren e pyeti:

— Po ti, or burazer.

— E, lere, — i tha Ahmeti dhe i tregoi si ishte puna. Rroku e vështroi edhe një herë, po këtë radhë me habi.

— Mos e ke pa gja rrugës? — pyeti malësori.

— Jo, — tha Rroku, — nuk e kam parë. Po as që duhet të ketë ardhur këndeje, se ka ditë që s'kalojnë maqina. Mos ka mbetur në K.

Malësori thithi fort cigaren dhe nguli vështrimin në rrugë, i humbur në mendime. Mendime pa fill e pa fund.

— Ku mund të ketë shkue, — belbëzoi sikur t'u drejtohej gropave të rrugës.

— Ti më mirë kthehu me mua, — i tha Rroku, — pastaj kollaj për ta gjetur.

— Hajt, mos humbisni kohë, — tha Besimi. — Edhe ti, Ahmet, nisu. Unë do të pres këtu.

— Të presësh këtu? — tha i habitur Ahmeti. Besimi ngriti supet sikur të thosh: «Ç'të bëj». Maqina e tij kishte mbetur rrëzë malit. Megjithë kundërshtimet e Rrokut, ai, sapo arriti dhe e gjeti

shokun në atë gjendje, lidhi të tri maqinat me kavo, dhe të tre ja nisën një luftë të ashpër për të nxjerrë maqinën që kishte shkarë. Një orë e ca luftë dhe në kohën kur të tre motorët ishin sforcuar shumë dhe të dy rrotat e prapme të maqinës së Rrokut prekën në xhade, Besimi kishte ndjerë një kërcitje. Dhe e kuptoi. Ndodhi ajo që duhet të ndodhte, dhe që Rroku e kishte parashikuar. U thye semiaksi. Kështu që duhet të priste në mes të rrugës gjersa Ahmeti t'i sillte ndonjë semiaks.

— E di çfarë, — tha Ahmeti si u mendua ca, — ti je mësuar të ecësh në rrugë të tilla me rimorkio...

— Pastaj? — pyeti Besimi.

— Pastaj... ja ti merr maqinën time...

Shoferëve u ndritën sytë. Ahmeti po bënte një gjë të madhe.

— Atëhere shkelja, Rrok, — tha Besimi dhe bashkë me Ahmetin u drejtuan nga maqina e tij. Edhe Rroku shkoi në maqinën e vet. Befas qendroi. Ju kujtua malësori. Ai kishte mbetur në mes të rrugës me vështrimin e mpirë lëshuar përdhe.

— Ej, burazer, do të vish? — i thirri Rroku.

Malësori sikur u shkund nga mendimet e tij të gjata si shirita resh. Pastaj, hodhi çapin e plo-gët drejt K. andej nga do të shkonte Rroku.

— Hip!

Ai hipi. U mbështet në sedile dhe hodhi vështrimin tej grykave të thella ku kishte filluar të zbriste lindja.

— Si është kjo punë, — belbëzoi. Ndërsa Rroku ndezi motorin.

«Shkelja, babi.»

«Ah, të harrova fare!» — tha me vete Rroku.

«Shkelja të kthehesh shpejt. Mami është bërë merak.»

«I ke treguar ti.» — Rroku qeshi dhe rregulloi fotografinë në xhamin e pasqyrës.

— Është vajza, — i tha atij malësorit. — Kam dy ditë pa e parë.

— Edhe unë kam dy ditë që e kërkoj, — tha malësori si me vete. Ai u mat të shtonte diçka. Rroku e vuri re. Mbase për ikjen e së motrës.

«Do të ma thotë vetë rrugës.» — mendoi dhe lëshoi fraksionin.

V

Marta vështronte nga dhoma e saj e komandimit, që qe vendosur në mes të asaj salle të madhe të uzinës, gjithë punën që bëhej në repart. Lart uturinjin vinçat «urë», ndërsa poshtë tyre lëvrinin njerëzit e veshur me kominoshe bojë qielli. Marta herë-herë vështronte aparatet, lëvizte ndonjë levë e prapë hidhte vështrimin përtej xhamave të mëdhenj ku ziente puna e oshëtinin krismat metalike. Po më shumë i pëlqenin gjuhërat e flakëve në dyert e furrave. Dhe kujtonte atë natën e ftohtë në mes të pyjeve... Sa kohë kishin kaluar që atëhere?

— Jepi, Marta! — dëgjoi zërin e brigadierit të furrës. Ajo ndërroi kursin. Nga gryka e furrës filluan të dilnin shufra të përskuqura metali. Tek vështronte shufrën, që rendte nëpër maqineri si një gjarpër i madh e i zjarrtë, mendonte rrugët e akullta e dredharake. Dhe rrugët i kujtonin Avniun, atë shoferin që e kishte gjetur atë natë, rrëzë

pyllit. Kishte ditë pa e parë. Se ai rendte pyjeve ose maleve me maqinën e vet dhe kthehej i lodhur...

Një natë ai kishte ardhur në shtëpinë e Rrokut. Dridhej nga të ftohtët.

— Kam ethe, — kishte thënë. Ata e kishin ndihmuar. Dhe Shpresa dhe Rroku dhe ajo që ishte ndodhur aty. Se Marta tani banonte në një hyrje, pranë asaj të Rrokut. Bile dhe vajza e vogël e Rrokut ja puthte ballin e djersitur.

— Xhaxhi Avni, do të shërohesh shpejt se më ke mua, — i thosh. Marta ndjeu diçka të çuditëshme atë natë. I vinte ta përqafonte, t'i fërkonte shpatullat e lodhura... Po Avniu nuk nxirrte zë, e vështronte i heshtur e i skuqur në fytyrë.

— Sonte do të flesh këtu, — i kishte dhënë urdhër Rroku, — me mua.

Ai nuk ishte përgjegjur. Pastaj kishte belbëzuar:

— Më duhet të shpie traversat e galerive, Rrok!
Në radhë të parë duhet të shërohesh.

Pastaj e kishte vizituar mjeku. Tha se ishte ftohur, dhe të nesërmen nuk duhej të ngrihej.

Ajo gjithë natën kishte menduar për të dhe për njerëzit që e rrethonin. Ashtu me zgjuarsinë e naivitetin e saj kishte menduar ajo. Mezi kishte pritur të gdhihej e të vente ta shihte si ishte. Mirëpo, kur më në fund ishte gdhirë e ajo ishte ngritur, Avniu nuk ishte më në shtëpinë e Rrokut...

Jeta në uzinë e kishte tërhequr të tërën. Se ishte ndryshe aty. Një jetë të tillë rrallëherë kishte bërë në fshatin e vet. Vetëm atëhere kur u krijua kooperativa dhe i vëllai organizonte aksionet e dimrit, kur të gjithë, burra e gra, me këngë në gojë, hapnin toka të reja, ndërtonin tarraca. Mirëpo, një gjë kishte mbetur pa ndryshuar. Ato nuk

kishin të drejtë të vendosnin për ndonjë gjë. Ato duhet të bënin ç'të thoshnin burrat. Madje edhe të martoheshin me... Ajo mendonte se kishte bërë mirë që kishte ikur. Po Rroku i kishte folur për të vëllanë. Ajo ishte mvrenjtur. I kishte folur shumë Rroku, dhe më shumë ish mvrenjtur ajo.

— Ta dish, Rrok, — kishte thënë Marta, — se për mua asht ma e vështirë.

Rroku e kishte vështruar thellë në sy. Pastaj kishte filluar të luante me të bijën, e cila kërkonte t'i tregonte ndonjë përrallë nga ato me djal'in e vogël partizan që vret armiq...

Ja, të gjitha këto i kujtoheshin Martës t'ek vështronte dritëzën e kuqe të shufrës së hekurt të dredhonte nëpër maqineri. Befas, në derën e madhe të repartit vuri re Avniun, që fliste me duar e me këmbë me sekretarin e Partisë. Ajo i thirri teknikut ta zëvendësonte dhe rendi te ai.

— Mirë, Avni, e kuptoj — i thoshte sekretari atë kohë, — po nuk ke të drejtë të nxehesh.

— Ta hajë dreqi! — shfryu Avniu. — Ata na sorollatin.

— Kush?

— Ata të furnizimit. Galeritë presin. Duan traversa. Pastaj sekretari qe larguar për të parë si ishte puna. Marta i doli përpara Avniut.

— Marta, — i tha ai, — isha nisur të vija te ti.

Vështrimi i saj u ndesh me sytë e tij të rrethuar me ngjyrë mavi. Avniu kishte ardhur t'i thoshte diçka, po tani që e kishte pranë, nuk dinte ç'ti thoshte.

— Sa ke ndryshuar Martë! — tha pastaj. Ajo vuri buzën në gaz. — E di pse erdha, — u kujtua

ai, — t'i thuash Shpresës se Rroku është nisur për në malësi.

— Pse? — e pyeti me habi ajo.

— Për elektrifikimin e një kooperative malore.

Mos harro, t'i thuash, — tha ai dhe u mat të largohej.

— Avni, po ti nuk do rrish sonte? — e pyeti ajo.

— Jo, — tha ai, — më duhet të shpie në K. traversa për galeritë.

Ajo e vështroi për një çast në shpatullat e gjera. Marta ishte e sigurtë se ai kishte dëshirë të bisedonte akoma me të, mbase të shkëmbente edhe fjalë të tjera. Po ai iku. Në K. prisnin minatorët, dhe kishte nevojë për traversa. U kthye ajo në vendin e punës. Në fytyrë i kishte ngrirë një buzëqeshje e njohur...

VI

Rroku i lodhur u mbështet në muret e zeza të kullës, ndërsa Pjetri u ngrit të merrte ca shkarpa për të gjallëruar zjarrin. Hijet e tyre dridheshin në mur, nën ritmin e flakës.

— Shumë-shumë një muaj e mandej vjen drita, — tha Pjetri duke ja hedhur shkarpat zjarrit, që menjëherë u gjallërua e ndriçoi errësirën që pllakoste në dhomë.

— Po, — tha Rroku.

— Na ke ndihmue boll, Rrok.

Rroku s'foli. Rrinte ashtu mbështetur në mur dhe përtypte mendimet. Mendime të thella e të kthjellta si ujët e Fanit. Kishte punuar shumë atë muaj. Dhe me njerëzit ishte njohur e kishte bise-

duar. U kishte folur për të ardhmen... Vetëm Pjetri e kishte vështirë. Prandaj, kishte vendosur të bisedonte edhe sonte me të. Duhej bindur plotësisht Pjetri, ndryshe, ç'kuptim kishte po të mos mbyllej krejt vraga që i ishte çelur në zemër. Ai e ndjente që Pjetri priste të niste bisedë. Atë ditë kur u njoh me Pjetrin, e pandehi për njeri fanatik e të trashë, që nuk sheh se ç'bëhet.

«Sa e egër është forca e zakonit» — kishte menduar.

Pjetri i kishte thënë se e motra që quhej Martë i kishte ikur nga shtëpia, sepse nuk donte të martohej me të fejuarin.

— Kjo është e natyrshme, — i kishte thënë Rroku.

— Po, por s'kishte ndonjë gjë të keqe, — kishte thënë Pjetri.

— Të martosh një vajzë me një që s'e do, është njësoj sikur ta vrasësh, — kishte thënë Rroku.

— Nuk asht ajo e para që martohet me shkuesi. — Pjetri ishte nxehur — puna asht se na e kena dhanë fjalën.

— Kur nuk e do, fjala e dhënë s'ka përse të mbahet, — kishte kundërshtuar Rroku.

— Jo, or!

— Po, — kishte thënë Rroku.

— Kjo fjalë s'ka si priset, — kishte thënë Pjetri duke tundur kokën. — Im atë ka lanë amanet. Se në kohë të luftës, bajraktari më pat vu mue në mur tuj i thanë nanës se po të mos tregonte ku ishte im atë dhe partizanët që kishin bujtë atë natë te ne, do të më vriste. Nana nuk tregoi dhe sa desh me më vra, i ati i të fejuemit të Martës më shpëtoi duke i premtuar bajraktarit

se do ta binte tim atë me duert e veta. Mirëpo, ai s'kishte pasë ndërmend me ba një gja të tillë, e im atë i premtoi se do t'i jepte të parën vajzë që do të bante, nuse për të birin.

— Eh, mirë, — kishte thënë Rroku, — këto gjëra mund të ngjasin, po tani kohët kanë rrjedhur ndryshe...

Këto mendonte Rroku, i mbështetur në murin e kullës. I kujtohej Pjetri i humbur në mendime me vështrim në rrugën e ngrirë. Dhe si ai vendosi më në fund të kthehej me të në K. ku mund të gjente të motrën. Pastaj, kur Rroku qe kthyer, qe takuar me Avniun, që i foli për Martën. Rroku qe habitur ca, pastaj kishte marrë takim me Pjetrin. Ai i kishte folë shumë duke ja shpjeguar të gjitha. Po Pjetri e kishte vështirë. Dhe këtë muaj kishte biseduar me të. Rroku qe munduar të mësonte ç'mendonte malësori. Ai ishte gëzuar për ardhjen e Rrokut dhe këtë natë i vinte keq që ai së shpejti do të largohej.

— Eh, or Pjetër, — nisi bisedë Rroku. — Ta dish sa ka ndryshuar Marta. Veç kjo puna jote e hidhëron shumë.

Pjetri trazoi padashur zjarrin me sy të ngulur në gjuhëzat e flakëve,

— Asht i randë turpi, Rrok, — tha pastaj me zë të ulët. — Asht i madh e s'asht kafshatë buke që të kapërdihet. Se tanë katundi e mban në gojë.

— Jo, Pjetër, — tha Rroku. — Ti si komunist nuk duhet të mendosh ashtu. Kur ti nuk e kupton fjalën e partisë, atëhere ç'mbetet për të tjerët? Ti duhet t'ua bësh të qartë se Marta dhe shoqet e saj kanë të drejtat e tyre.

— Kanë po...

— Kanë të drejtë dhe të marrin atë që u do zemra, — vazhdoi Rroku.

Pjetri e vështroi me vëmëndje.

— Mos e ke fjalën për atë shoferin tjetër? — pyeti pastaj.

— Unë nuk e kam fjalën për njeri, — tha Rroku. Po Marta ka të drejtë të marrë atë që do, ashtu siç e kemi dhe ne atë të drejtë. Duhet të dish se ajo ka çarë me guxim një rrugë të akullt, të vështirë. Rrugën e zakoneve prapanike e të kanunit ka çarë ajo. Po aq e vështirë sa ajo rruga ku më gjete ti me shoferët. Dhe ne duhet ta ndihmojmë. Ashtu siç më ndihmuan mua shokët. Ndryshe do të rrokullisemi në greminë.

Pjetri e dëgjonte me vëmëndje pa i ngritur sytë nga zjarri që bubulonte në vatër.

— Ti nuk duhet të bëhesh pengesë në rrugën e saj, Pjetër. Ti nuk mund të bëhesh pengesë. Se jemi ne. Dhe në fshat nuk janë të shumtë ata që flasin poshtë e lart. Tektuk ndonjë flet, na pengon, i pengon Martat. Po nuk do t'ja arrijnë, se bota jonë, rruga jonë, është e kuqe, e zjarrtë, e drejtë... Rroku i zgjati një cigare dhe e ndezi dhe vetë.

— Prandaj, Marta e ka kuptuar këtë rrugë dhe ecën nëpër të e sigurtë...

Pjetri e dëgjonte pa folur. Thithi fort cigaren dhe pastaj psherëtiu.

— Eh, Rrok, sa e vështirë asht!

VII

Se si kishte hyrë në atë botën e madhe të uzinës, Marta e mbante mend mirë. Se e shihte çdo

mëngjez, kur ngjitej në dhomën e komandimit dhe fillonte të lëvizte levat. Dhe atë mëngjez me një barrë mendimesh u ngjit në dhomën e saj. Veshi skufjen dhe priti urdhërin e brigadierit «Jepi Marta»! Kishte kohë që e dëgjonte atë zë, kishte kohë që vështrimi i sajë i hirtë shikonte dritaren e kuqe të repartit të madh. Dhe i dukej sikur kishte hyrë në një botë të madhe, të kuqe...

Brigadieri ja bëri me dorë. Ajo shtypi disa susta. Nga gryka e furrës, vërsheu një dritë e kuqe që filloi të rendte nëpër maqineri, duke përhapur shkëndija e duke marrë forma të ndryshme. Ja si ajo drita e kuqe kishte ndryshuar ajo...

E vështronte me vëmëndje të madhe dritën e kuqe, që kur doli nga gryka e furrës e gjersa u shtri e transformuar në një mbajtëse pranë derës së madhe të repartit. Ajo kishte humbur në atë pamje sa ju duk sikur nga dera e repartit hyri një vajzë e re që i ngjante shumë, e veshur me një fustan dosido, që i rrinte i gjerë e i dukej i shkurtër. Vajza u fut me ndrojtje në repart pas një njeriu shtatlartë, që dukej sikur ndjente bezdi të ecte më këmbë. Njeriu vështronte vinçat me sytë e qelë, të mësuar me to, ndërsa vajza... Ja Marta e shihte të rrudhte sytë me frikë, gati të vinte duarët mbi kokë sa herë që ndonjë nga ata vinçat e mëdhenj e të hekurt rrëshqiste me shpejtësi e qendronte mbi kokë të saj, në tavanin e lartë. Marta e shihte vajzën e ecte pas njeriut e shoqëruar nga një sinfoni krismash e gërvimash metalike, të ecte nëpër një botë të madhe e të hekurt, e vetja i dukej e vogël, e vogël... Marta e pa të kalojë para furrave. Njeriu i fuqishëm ja bën me dorë njërit nga ata me syze të zeza që futi

një mashë të gjatë e me një kupë në krye në gojën e zjarrtë të furrës e mori që andej një lëng të kuq, që e derdhi pastaj e diç urdhëroi. Vinçi fluturoi mbi furrën e nxehtë. Ajo vajza u afrua më pranë.

«Shiko!» — i tha njeriu.

Nga goja e furrës filloi të derdhej një lëng i zjarrtë e i nxehtë, që u rrokullis pastaj në një kazan të madh duke përhapur mijëra stërkala të zjarrta. Njerëzit me syze që rrinin rreth tij ju dukën të mëdhenj, të fuqishëm, të kuq. Ndërsa ajo, një grimcë e vogël në këtë botë të madhe të zjarrtë e të kuqe. Po sidoqoftë vajza i dukej Martës një grimcë e zjarrtë, e purpurt në ato mijëra stërkala.

«Ah, erdhe Rrok?» Atyre të dyve u qe afruar brigadieri i furrave:

«Erdha».

Kështu kishte hyrë ajo në uzinë.

...Rroku e la me brigadierin. Vajza po ecte tani pas atij njeriu, që ishte shumë i mirë, që e kuptoi ndrojtjen e saj dhe që filloi t'ja shpjegonte të gjitha.

«Ky do të jetë ndonjë nga ata komunistët e vërtetë që më tregoi Avniu» — tha me vete vajza. Ajo bota e zjarrtë e madhështore sikur nuk i dukej aq e madhe Martës apo më mirë ajo vajza e vogël, ju duk më e rritur.

Marta ndërroi kursin, shtypi përsëri ca susta, e ndoqi me sy pastaj dritën që filloi të endej nëpër maqineri.

«Po ashtu isha unë atëhere — tha me vete ajo. — «Dhe ashtu si ajo drita fillova të ndryshoja». I dukej sikur ajo drita i shëmbëllente shumë asaj vajzës që e quanin Marta dhe që kohë më pas

ndërroi fustanin e gjerë me kominoshe. Ç'kishte hequr ajo vajzë për të veshur pantallonat! Ja, mu si ajo drita që skuqur. Po brigadieri i furrave i kishte folur shumë dhe ajo që bindur. Pastaj, vajza me kominoshe që ngjitur në atë kullën me xhama, që ngrihej në mes të repartit. Aty ishte një djalë i ri. Prapë që skuqur si ajo pllaka që rendte nëpër maqineritë e repartit, tek e vështronte atë djalë t'i shpjegonte aparaturën.

Pastaj kishin kaluar ditë dhe, vajza me kominoshe ishte zhdukur, ose jo, zuri vend aty në karricken e Martës me leshra të prera e me sy të ngulur në botën e madhe e të kuqe. Vajza me kominoshe që shkëmbyer me Martën, një vajzë e zgjuar, që vështronte e menduar dritën e purpurt, që ushqente atë botë të madhe...

— Marta, moj! — Ajo u përmend nga ai ëndërrim i këndshëm. — E paske humbur fare! — Në pult ishte ngjitur tekniku.

— Jo, — belbëzoi ajo.

— Posi, — ja bëri tekniku. Shko se të pret Rroku.

— Ka ardhur? — e pyeti ajo.

— Po, tha tekniku.

Rroku kishte hyrë në repart duke ecur me atë hapin e vet të madh e po bisedonte me fonditorët. Seç u tregonte ai. Nganjëherë qeshnin. Marta i doli përpara. I tha se e kishte marrë malli.

Rroku e vështroi dhe qeshi.

— Marta, sot mos u vono, — i tha ai, — do të festojmë ardhjen time. Avniu do të kthehet shpejt. I thuaj se unë kam ardhur dhe sille në shtëpi.

— Unë ta sjell? — u hodh ajo.

Rroku e vështroi thellë në sy. Avniu kishte

filluar të ndruhej nga Marta dhe zor se do t'i bindej asaj. Ndodhë nganjëherë që njeriut që do, i largohesh më shumë se kujt do tjetër.

— Mirë, do ta sjell, — tha e vendosur Marta.

Rroku u nda me të tjerët dhe doli. Marta, jo pa një farë shqetësimi, e ndoqi me sy.

* * *

Po, ishte larguar shumë vetëm ai, të cilit i kishte borxh jetën... Ajo duhet ta takonte Avniun, ndërsa ai rendte gjithmonë, herë i mardhur e herë i djersitur në rrugët e akullta ose të mbytura me pluhur.

Në fillim Avniu që afruar shumë me të. I sillte ndonjë gjë kur kthehej nga rrugët; kthehej fytyrëndritur e tërë gjallëri.

— Avni, mos u harxho shumë për mue, — i kishte thënë ajo një ditë. Ai kishte ndezur një cigare.

— Kam prerë dy bileta, Martë, — i kishte thënë njëherë tjetër para se Rroku të shkonte në malësi.

— Po për Rrokun e për Shpresën? — e kishte pyetur.

Ai prapë kishte ndezur një cigare dhe kishte heshtur. Nuk i tha fare se atë ditë Rroku do të shkonte te vjehri me gjithë Shpresën dhe vajzën. Dhe prandaj s'kishte prerë dhe për ta bileta. Pastaj, që munduar të largohej nga ajo. Ja, vinte ajo dhe ai ngrihej e ikte. Pastaj, kishte humbur rrugëve. Madje i kishte hyrë dhe shkollës. Ishte në vitin e fundit të gjimnazit. Rroku kishte shkuar në malësi atë muaj. E kishin thirrur dhe ai s'ua kishte bërë fjalën dy. Kështu ishte zhdukur dhe Avniu. Ajo tërë muajin s'e kishte parë fare.

— Ka ikur tranzit, — i kishte thënë Shpresa.
— Ka shumë punë. Ai ka vendosur të punojë edhe për Rrokun.

— Mos u mërzit, teta Marta, — kishte thënë vajza. — Xhaxhi Avniu do të kthehet bashkë me babin. Ke për të parë. Martës i ishin mbushur sytë.

Befas, dëgjoji borien e fortë, të njohur, të dashur, të shytës. Marta ktheu kokën. Ai ishte. Ja tani do t'ja shkelte e do të rendte me shpejtësi.

«Këtë radhë s'të la të ikësh.» — Marta i doli përpara në mes të rrugës. Maqina që kishte filluar të merrte shpejtësi frenoi në vend. Ajo i liroi rrugën. Hapi derën dhe u hodh lart.

— Te Rroku! — i tha.

— Pse taksi e bëre ti? — tha Avniu. — Pastaj del dhe në mes të rrugës.

— Në mes të rrugës të marrin shoferët, — tha Marta.

— S'prish punë po ta bësh rrugën më këmbë.

— Erdhi Rroku dhe më tha se duhet të shkojmë te ai. Unë po të prisja.

-- Po më prisje?

-- Po.

— Mua?

— Po, ty.

Avniu ndezi një cigare.

— Nuk do të vij. Do shkoj të shkarkoj.

— Pse s'don me ardhë?

— S'kam kohë.

— Edhe sikur të pres prapë?

Avniu i tha se do të shkonte në Laç. Po të donte, mund të shihte urdhërin e shërbimit.

— Avni! — Ai thithi fort cigaren.

— Ç'është?

— Rroku tha se duhet me festue kthimin prej malësie. Thuej Avniut të vijë patjeter.

— Ohu, kështu thua ti, — tha Avniu.

— E mirë kështu them unë, Pse mos me ardhë kur them unë? Folë pra, ta hajë dreqi! — Marta thirri e nxehur. Sytë e mëdhenj i kishte picërruar e ja kishte ngulur djaloshit tërë inat. Avniu s'e kishte parë kurrë kaq të nxehur.

— Hajt jepi, shko shkarko, shpejt, nisu në Laç pastaj, a në dreq! — thirri Marta dhe u ngjesh mirë në sedile me vështrimin hedhur në rrugën e gjatë. Avniu shkeli gazin, pastaj tha:

— Po më urdhëron?

— Po.

Avniu ngriti supet. Pastaj vuri buzën në gaz.

— Eh, mirë! — ja bëri dhe ja shkeli më fort nëpër asfaltin e zi. Pastaj i hodhi sytë vajzës.

«A të ka thënë njeri se je e bukur Marta» mendoi ai. Jo s'i kishte thënë njeri. Pastaj, ajo Marta kishte filluar të ndryshonte dhe atij ju duk vetja shofer hesapi.

«Nuk duhet të më duket vetja shofer hesapi», —mendoi.

Kishin arritur te ajo shtëpia e vogël ku flinte Avniu.

—Shko përpara ti, —tha ai.

— Jo, do të pres.

* * *

Në fillim hyri Marta, ndërsa pas saj Avniu. Në shtëpinë e Rrokut nuk kishin ardhur akoma ata që ishin ftuar. Vetëm brigadieri i furrave ndih-

monte Shpresën në guzhinë, ndërsa Rroku kishte vajtur të mirrte birrën, që e kishin vënë në akull. Vajza e Rrocut, që doli nga guzhina me të parë Avniun, ju hodh në qafë.

— Mos ik më, — i tha.

— Nuk do të iki, — tha Avniu, — tani gjeje ç'të kam sjellë.

— Një çokollatë të madhe dhe një çadër të vogël.

— Aha, vetëm çokollatën gjeje, — tha Avniu. Ai ja dha, dhe ajo rendi në guzhinë. Avniu mbeti vetëm me Martën. Ajo ishte rehatuar në një kolltuk dhe vështronte një pejzash të varur në mur ku ishin vizatuar ca male të ashpëra ngjyrë hiri dhe në gjoks të tyre shtyllat e tensionit të lartë. Pastaj, vështrimin e rrëshqiti në fytyrën e nxirë nga dielli të shoferit. Kishin ndryshuar që të dy. Avniu dukej më i rritur, dhe në ballin e gjerë i kishte zënë vend një mendim i thellë. Ndërsa Marta... Atij nuk i besohej që të ishte ajo, Marta që kishte gjetur atë natë dimri në mes të rrugës. Edhe ajo mendonte për ndryshimin e saj. Peizashi i varur në mur i kujtonte malet ku në vend të shtyllave të tensionit mund të shikoje ndonjë grua me bucelë në krah, të rrethuar me vetminë e shtigjeve shkëmbore. A thua të kishte ndryshuar edhe fshati i saj? Dhe në vend të ndonjë gruaje të vetmuar të vizatoheshin shtyllat e tensionit? Sa kohë kishte kaluar që atëhere? Mbase një vit e gjysmë. Në një kohë të tillë ndryshojnë dhe njerëzit dhe malet...

Doemos dhe ajo kishte ndryshuar. Mbase po ta shihnin shoqet e saj nuk do ta njihnin. Bile dhe Pjetri do ta kishte të vështirë.

Mendimet i silleshin rreth e rreth, herë të

turbullta e herë të kthjellëta si ujërat e përrënje kur shkrin bora. Megjithëse dukej e qetë ndjente një emocion të pakuptueshëm si ata udhëtarë që do të nisen në rrugë të gjatë. Mbase dhe nga prania e Avniut, i cili kishte marrë një album në tryezë dhe vështronte fotografitë. Ajo e vështroi një çast profilin e tij të nxirë nga dielli ku viheshin re shenja lodhjeje. Në fillim i kishte ardhur çudi me këta njerëz. Niseshin orë e pa orë në rrugë të gjata e të vështira, ktheheshin dhe përsëri niseshin në rrugë të tjera. Megjithatë, ishte munduar t'i kuptonte. Kishte parë dhe të tjerët që shkrinin metalin në furrat e përskuqura. Ata ishin njerëz të rinj, të fuqishëm, njerëz të një bote të madhe në të cilën sapo kishte hyrë. Dhe përsëri mendimet rendnin përtej pejsazhit të varur në mur. Aty ku ishin malet e vërteta dhe shtigjet shkëmbore. Aty ishin dhe shoqet dhe Pjetri...

Në derën e dhomës u duk Rroku me një arkë në duar. Avniu u ngrit më këmbë. Marta i pa të përqafoheshin dhe të çmalleshin, pastaj të dy shpunë arkën në guzhinë. Marta mbeti vetëm me mendimin te ata të dy. Sa ngjanin njeri me tjetrin. Në fytyrë jo, po seç kishin diçka të përbashkët që i lidhte ata dhe i bënte të ngjanin. Dhe Shpresa ngjan me ta, dhe brigadieri i furrave. Bile dhe ajo... Sytë i vajtën përsëri në pejzashin e murit. Në shtigjet shkëmbore ecte një njeri. Një njeri i lirë, i qeshur, i mbështjellë me diell, ecte në to. Ai njeri ngjante me Martën e vogël, që ecte e rritej nëpër shtigje. Pastaj njeriu u shndërrua me një shtyllë tensioni. Megjithatë, ajo mendoi se duhej të ecte një njeri në to...

— Hej, Marta, të zuri gjumi? — Rroku ishte

kthyer në dhomë. Ajo u përmend dhe vuri buzën në gaz.

— Jo, po androja, — i tha. — Shihja atë figurë dhe më ngjante me fshatin tim.

— Aha! — ja bëri Rroku. — Është andej nga Dukagjini. Piktori ka dashur të tregojë se atje po ngjitet drita. — Rroku vështroi njëherë pejzashin, pastaj vazhdoi: — Në fshatin tënd' isha unë.

— Ti? — Marta u habit. E dinte që Rroku kishte qenë në malësi, po nuk ja kishte marrë mendja se do të shkonte në fshatin e saj.

— Çuam dritën, — tha Rroku.

— Ashtu?!

— Po, — tha Rroku. — Fshati juaj sipas planit mori dritë. Unë isha caktuar të organizoja punën. Takova dhe Pjetrin. Ai na ndihmoi shumë.

Marta nuk foli. Uli kokën dhe mbërtheu sytë në qilimin e butë të dhomës.

— Disa net i kalova në shtëpinë tuaj, — tha Rroku.

Marta këputi vështrimin nga qilimi dhe e hodhi në fytyrën e menduar të Rrokut. Ndënjën një çast pa folur sikur të donin të arrinin mendimet e njeri-tjetrit.

— Bisedova gjatë me Pjetrin, — tha Rroku. — Megjithatë ai e ka të vështirë.

— Doemos, — tha Marta.

— Njerëzit në fshat kanë filluar të mendojnë ndryshe për ty. Sidomos shoqet. Ato të duan, ato mendojnë se ti ke bërë mirë...

Martës i ngriu në fytyrë ajo buzëqeshje e njohur. E ndjente veten të kënaqur. Shoqet e donin, e kuptonin. Kishte mbetur vetëm Pjetri. Megjithatë,

tani ai nuk ishte më kërcënues, ai lëkundej, prandaj mendoi se mund të bisedohej me të.

«Do ta kem më lehtë» — mendoi. «— Bile ai do të bindet dhe do të më përkrahë». — Ajo mendonte se ai duhej ta përkrahte. Se kishte të tjerë aty në fshat që e mbanin kanunin në gjunjë. Se kishte të tjera shoqe që mund të merrnin pyjet e frikshme nëpër rrugë të akullta.

— Pjetri është djalë i mirë, — tha Rroku. — Ai nuk do ta bëjë më një gabim të tillë. Në bisedën e fundit, që pata me të, unë u binda se ai ka filluar të ndryshojë...

Në dhomë hyri Avniu, pas tij hynë metalurgët. Rroku u doli krahëhapur përpara... Marta i vështronte të gjithë. Ata ishin njerëz të thjeshtë, nuk ndruheshin, po vinin buzën në gaz dhe i rrihnin gjoksin njëri-tjetrit. Mendja i vajti përsëri te pejsazhi në mur. Ju duk sikur ai ishte ndriçuar më shumë dhe shtyllat e tensionit llamburitnin nën dritën e diellit. Pastaj, ju afrua atyre me atë buzëqeshjen e njohur në fytyrë...

* * *

Maqina e Rrokut priste te kthesa me motor të ndezur. Megjithatë, ata ecnin ngadalë sikur nuk drejtoheshin aty. Marta diç thosh, ndërsa ai e dëgjonte në heshtje. Avniut se si i vinte. Kur e kishte gjetur në mes të rrugës nuk kishte menduar se kush ishte dhe për ku ishte nisur. Dhe e kishte pandehur për një udhëtare të thjeshtë. Pastaj, ajo nuk kishte qenë një udhëtare e thjeshtë. Ajo ishte një udhëtare që kishte ecur nëpër rrugë jo të za-

konshme, nëpër rrugë të akullta, dhe ai e kishte ndihmuar t'i kapërcente. Mirëpo bota e tyre e madhe kishte ndikuar më shumë te ajo.

Rroku që nga maqina i ra bories për t'u thënë të nguteshin.

— Domethënë ke vendosur? — tha Avniu.

— Po, — tha ajo, — kam vendosur. Megjithëse më vjen keq të ndahem nga ju, nga ajo bota juaj e madhe dhe e kuqe. E di Avni? Mua reparti më asht duk gjithmonë një botë e madhe dhe e kuqe. — Avniu vuri buzën në gaz.

— Mbase nuk je gabuar, — i tha.

— Unë nuk mund të rri dot ma në botën tuaj, — tha ajo.

— Pse? — pyeti Avniu.

— Nuk mund të rri dot ma, — tha prapë ajo. E di që e reja ka kohë që ka filluar të hyjë në fshat. Këtë e di mirë. Po në ato anët tona mund të qëllojë të gjesh edhe ndonjë vajzë tjetër në mes të rrugës. Unë nuk do ta la atë të dalë në mes të rrugës. Unë do ta ndihmoj atë. Tash, — ajo u për-tyt një çast, — mbase do kem dhe Pjetrin krah.

— Po, — tha Avniu.

— Tash që ka ardhë drita elektrike do ta kem ma lehtë.

«Ti je një grimcë e purpurt e shkëputur nga bota jonë e kuqe», — mendoi Avniu.

— Vajzat tona e kanë të vështirë akoma, — vazhdoi ajo. — E kanë vështirë se edhe prindët e tyre e kanë të vështirë. Unë do të luftoj. Unë do t'i ndihmoj. Si mendon ti, a kanë nevojë ato për mue?

— Si thue, Avni?

— Mendoj se kanë nevojë.

— Atëhere ma jep dorën, — tha ajo.

Ai ja dha dorën. Ajo ja shtrëngoi fort. Edhe ai ja shtrëngoi fort. Në vështrimin e tij pas shpatullave të malësORES ngriheshin malet e hirtë, me një botë të tërë të fshehtë. Po ai ishte i sigurtë se ajo si një grimcë e kuqe e botës së tyre të zjarrtë, do të ndriste e do të zbulonte çdo të fshehtë. Dhe ai do të rendte nëpër të tjera rrugë të akullta duke zhbiruar errësirën e ftohtë me dritat e maqinës së tij.

Megjithatë atij i vinte keq që po ndahej nga Marta. Nga ajo Marta nuse.

— Mua më vjen keq që po ndahemi, — tha ai.

Boria e fortë e maqinës u dëgjua përsëri. Rroku doli në dritare dhe u thirri të vinin.

— Nuk duhet të të vijë keq, — i tha ajo. Ata u vështruan në sy. Ajo nuk u skuq nga vështrimi çapkën i shoferit. — Nuk duhet të të vijë keq. Unë pa tjetër duhet të ndodhem midis shoqeve të mia. Ata kanë nevojë për mue. I ndej sytë e tyne të ndrojtun e me besim në mue.

— Ne do të takohemi prapë, — tha ai.

Ata ishin afruar te maqina e Rrokut. Avniu nuk e vështronte më. Ajo nuk kishte hyrë vetëm në botën e tyre, por edhe në botën e tij.

— Do të takohemi — tha ajo.

Pastaj shtrënguan duart...

PASQYRA E LENDE

Në një natë të ftohtë	5
Mbi një platformë betoni	18
Për shokun.	45
Çelësi Nr. 14.	67
Rrugë të akullta	79

